

1 E martë, 10 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretari i
7 seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të
9 nderuar Gjykatës, kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
13 të gjithëve. Vërej për procesverbal që të akuzuarit janë të
14 pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

15 Do të vijojmë me deklaratat përmbyllëse në këtë çështje
16 gjyqësore. Fjalën e ka ende Prokuroria e Specializuar e cila
17 duhet të përfundojë deri në pushimin e drekës. Pas pushimit të
18 drekës do të fillojë Mbrojtësi i Viktimave me fjalën e vet.
19 Sipas rendit që kemi caktuar për deklaratat përmbyllëse, të
20 cilën mund ta shihni më konkretisht me dokumentin me numër
21 F03639.

22 Dua t'ju informoj që është parashikuar që sot të
23 përfundojmë në orën 16.45. Do të kemi një pushim në orën
24 10.30, do rifillojmë në orën 11.00, pra, gjysmë ore. Do kemi
25 pushim në orën 12.00 sot deri në orën 13.30 dhe do të kemi më

1 pas 15 minuta pushim në orën 15.00, dhe do të fillojmë në orën
2 e tyre individuale.

3 Nuk do të përsëris dosjen tonë përfundimtare apo atë çka
4 kanë thënë tashmë folësit e tjerë. Por, dua të kuptojmë
5 aspektet e mbetura të provave që kemi lidhur me përgjegjësinë
6 e të akuzuarve. Unë do të fokusohem në disa prova për secilin
7 nga të akuzuarit dhe argumentet që ka bërë Mbrojtja në dosjet
8 e tyre përfundimtare. Duke qenë se e njëjta sjellje që
9 përcakton përgjegjësinë sipas NKP I apo NKP III, në mënyrë
10 alternative po ashtu përcakton përgjegjësinë e tyre sipas
11 ndihmës dhe inkurajimit dhe përgjegjësisë eprorë, prezantimi
12 im atëherë do të jetë për format e ndryshme të përgjegjësisë
13 penale.

14 Fillojmë me z. Hashim Thaçi.

15 Të gjithë diapozitivët duhet të jenë publikë përveçse kur
16 do t'ju them unë ndryshe.

17 Mbrojtja e Thaçit argumenton në paragrafët 124 deri në
18 127 të dosjes së vet se ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej
19 dyshimit të arsyeshëm se Thaçi ka qenë një prej anëtarëve
20 themelues të UÇK-së apo anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, ose
21 Shtabit Qendror, përpara 1998-s.

22 Z. Tieger foli shkurtimisht për këtë, por argumentet e
23 Mbrojtjes së Thaçit në fakt nuk qëndrojnë. Mbrojtja e Thaçit
24 keqorienton kur thonë se Azem Sylja një prej anëtarëve të NKP-
25 së ka qenë në pozicion të dinte kush kanë qenë anëtarët

1 fillestarë të Shtabit të Përgjithshëm. Kjo, në fakt, është në
2 mospërputhje me atë çka është thënë për Hashim Thaçin si një
3 nga themeluesit e UÇK-së. Në provën 847 Syla flet për
4 përbërjen e parë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ai
5 evidenton Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin si anëtarë
6 themelues.

7 Në provën 1875, Syla në fakt flet për diçka tjetër,
8 gjegjësisht se çfarë konsideronte ai një takim themelues të
9 UÇK-së në dhjetor 19993. Ai qëllimisht nuk i përmend
10 pjesëmarrësit në atë takim, as nuk pretendon se ka renditur të
11 gjithë themeluesit e UÇK-së që kanë qenë pjesëmarrës në këtë
12 mbledhje. Prova të tjera, sikurse në provën 186 pretendojnë që
13 themelimi i UÇK-së është kuptuar, në fakt, në prill 1993, në
14 një mbledhje tjetër ku nuk ka marrë pjesë Azem Syla, por në të
15 cilin ka marrë pjesë Adem Jashari, Hashim Thaçi, Kadri Veseli,
16 Jakup Krasniqi dhe të tjerë.

17 Provat tregojnë vetëm dallimet në cilësimet e momentit
18 themelues të UÇK-së, por kjo nuk është një mospërputhje nëse
19 ishte apo jo Thaçi një prej themeluesve. Sikurse e tha z.
20 Tieger, kur e pyetën Thaçin ZPS-ja kur u bëtë anëtar i Shtabit
21 të Përgjithshëm, përgjigja e tij ishte se dihej nga të gjithë
22 që ai ka qenë një prej themeluesve të UÇK-së.

23 Provat e "dorës së parë" ku mbështetet Mbrojtja e Thaçit
24 në paragrafin 127 të dosjes së vet, ku përpuqen të na tregojnë
25 që Hashim Thaçi është kyçur në Shtabin e Përgjithshëm në

1 nëntor 1998, në fakt, burojnë nga Sokol Bashota dhe vetëm nga
2 Sokol Bashota. Dëshmia e tij, në fakt, kontradiktohet nga një
3 mal me prova, përfshirë edhe vetë përshkrimin e Hashim Thaçit
4 në lidhje me punimet e brendshme të Shtabit të Përgjithshëm të
5 UÇK-së përpara, edhe këtë mund ta shihni në provën 771 dhe
6 provat shtesë të cilat mund t'i lexoni në dosjen 101, 482 të
7 dosjes sonë. Nuk është e qartë, në fakt, as nëse Mbrojtja e
8 Thaçit vetë e beson Bashotën lidhur me këtë, sepse ata
9 argumentuar në deklaratat hyrëse se Thaçi është ftuar të
10 bashkohet me Shtabin e Përgjithshëm "në pranverën e 1998-s"
11 përpara se të përshkruanin logjistikën dhe përgjegjësitë për
12 mediat që ka patur ai; këtë mund ta shini në transkript në
13 faqe 2303, 2304.

14 Provat që ka dhënë Sokol Bashota nuk mund të jenë të
15 besueshme lidhur me këtë pikë konkrete, pra, kjo tregon se
16 duhet parë me kujdes besueshmëria e tij lidhur me aspektet që
17 ka diskutuar sepse ai, në fakt, duket që ka qenë në favor të
18 të akuzuarve.

19 Nga pozicionet e Thaçit pranë UÇK-së, pra, për shkak të
20 pozicioneve që ka pasur në UÇK ai ka kontribuar në një sërë
21 veprash penale të pafundme të cilat ne i kemi diskutuar në
22 paragrafët 482, 507 të dosjes sonë. E nuk është thjesht
23 kontributi që i ka dhënë UÇK-së për qëllimet e përgjithshme
24 politike apo kontribute neutrale, siç diskuton Mbrojtja e
25 Thaçit në paragrafët 112 dhe 118. Mbrojtja e Thaçit mbështetet

1 shumë, në fakt, në çështjen e Gjykatës Penale Mbarushimana,
2 dhe citojnë me hollësi vendimin e konfirmimit të na japin një
3 ilustrim se si kontribute për qëllime politike nuk mund të
4 jenë kontribute për vepra penale. Ai rast nuk na ndihmon të
5 kuptojmë çështjen që kemi aktualisht përpara këtij Trupi
6 Gjykues. Gjykata penale nuk përdor Ndërmarrjen e Përbashkët
7 Kriminale. Kryerja e përbashkët atje përkufizohet si
8 bashkëkryerje e tërthortë dhe janë elementë të ndryshëm
9 krahasuar me NKP-në. Mbrojtja e Thaçit thotë që Mbarushimana u
10 akuzua për bashkëkryerje të tërthortë sipas nenit 25(3)(d) të
11 statutit të Gjykatës Penale. Nuk është e vërtetë sepse ky nen
12 nuk flet për bashkëkryerje të tërthortë. Në fakt, Mbarushimana
13 u akuzua për përgjegjësi të tërthortë penale e cila nuk mund
14 të krahasohet me çështjen që ne kemi aktualisht. Jurisprudenca
15 e Gjykatës Penale, në fakt, nuk e trajton fare kontributin e
16 madh që ka përgjegjësia penale në nenin 25(3)(d). Këtë mund ta
17 shihni edhe në paragrafët 1242, 1344 të aktgjykimit Al Hassan.
18 Edhe një citim tjetër në kontekstin tonë mund të gjendet
19 në paragrafin 1876 të çështjes 002/02 aktgjykimi i apelit
20 përpara ECCC, ku në fakt trajtohet NKP-ja, Ndërmarrja
21 Kriminale e Përbashkët, pra, dhe thotë që të gjitha
22 veprimtaritë që janë në pamje të parë të palidhura me kryerjen
23 e krimeve duhen marrë parasysh kur të peshohet kontributi që
24 është dhënë në kryerjen e një vepre penale.

25 Edhe më e rëndësishme, në fakt, Hashim Thaçi ka qenë një

1 përkrahës i drejtpërdrejtë i qëllimit të përbashkët kriminal.
2 Këtë mund ta shihni më konkretisht për mënyrën se si ai flet
3 për LDK-në, një prej grupeve që shënjestronte politika ndaj
4 oponentëve.

5 Në ekran keni një raport të shtabit regjional Liria që
6 është diskutuar në T7799, 7800. Ndërhyrja e Thaçit nuk mund të
7 kishte qenë e qartë -- ai nuk ishte i qartë. Ai deklaroi se
8 ata "që nuk e njohin Shtabin e Përgjithshëm janë kriminelë dhe
9 ne nuk do t'u japim armë kriminelëve, por ne do të luftojmë
10 kundër tyre".

11 Ja ku kemi provën 486, ku në një moment të tensionuar me
12 Tahir Zemajn, Thaçi i drejtohet dhe i thotë, "Do të të luftoj
13 Tahir Zemaj njësoj si serbët, ty dhe njësitë e tua!".

14 Dhe ky është i njëjti mesazh që do ta shihni shkurtimisht
15 në Komunikatën 53, ku më 18 shtator 1998 Shtabi i Përgjithshëm
16 deklaroi se:

17 "Vetëm në Sferkë, Prapaqan dhe Baran, ku dezertorët, ish
18 ... anëtarët e UDB-së aktualisht 'institucionalistët' si Tahir
19 Zemaj kanë influencë, armiku nuk gjeti rezistencë, pavarësisht
20 faktit se këto fshatra u dogjën e u përvëluan e u shkatërruan.
21 Një ditë këta persona do të mbajnë përgjegjësi për dëmet që po
22 i shkaktojnë popullit dhe mëmëdheut."

23 Kjo është e qartë, pra, ky është një mesazh i qartë për
24 ata që ishin -- i pengonin kontrollin UÇK-së. Fjalët që i ka
25 thënë Thaçi Zemajt u përkthyen në fjalë, në formulim në një

1 komunikatë dhe u bënë realitet dy ditë më pas ku u ndalua
2 delegacioni i Qirezit edhe kulminoi me kërcënimin e z. Thaçi
3 kur iu tha "do t'ju vrasim në Prishtinë".

4 Të përshkruash kontributet e Thaçit si neutrale është
5 absurde sepse ka prova për të vërtetuar të kundërtën. Nuk ka
6 qenë, nuk është kontribut neutral të thuash këto fjalë nga një
7 pozicion siç kishte Thaçi. Dhe nuk është kontribut neutral të
8 marrësh në pyetje, të kërcënosh, të rrahësh personat në Qirez.

9 Gjithashtu mund të shihni një lidhje të qartë mes fjalëve
10 të Thaçit, fjalëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe krimet për
11 të cilat akuzohen në paraqitjen e tij publike në provën P1256.
12 Ka dhënë dëshmi Nuhi Bytyqi dhe ka thënë se e ka filmuar
13 Hashim Thaçin kur e ka thënë këtë më 30 tetor 1998, dhe këtë
14 mund ta gjeni në faqet 16722, 16728 të transkriptit të tij.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Nuhi Bytyqi: "... si tërësi e forcave të armatosura të
17 Kosovës, nën udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të saj,
18 gjatë këtij viti u përball kundër shumë ofensiva të pushtuesit
19 serb. Ajo arriti t'u bëjë ballë me sukses të gjitha këtyre
20 ofensivave, kështu që Ushtria Çlirimtare e Kosovës është më e
21 përgatitur si në planin kombëtar dhe anë atë ndërkombëtar. Në
22 planin kombëtar, Ushtria Çlirimtare e Kosovës përkundër
23 propagandës dhe luftës speciale që u bë para, gjatë dhe pas
24 ofensivave të pushtuesit serb i ndihmuar edhe nga elementët
25 autonomistë, ajo arriti që vetëm të konsolidohet, të

1 profesionalizohet, e sot ka arritur shkallën më të lartë të
2 organizimit të saj politiko-ushtarak".

3 Z. HALLING: [Përkthim] Lufta speciale. Elementët
4 autonomistë. Paraqitja e parë.

5 Mbrojtja e Thaçit argumenton në paragrafët 244, 247 të
6 dosjes se ky fjalim nuk duhet të merret për bazë, dhe të
7 thuash që Hashim Thaçi në mënyrë publike ka bërë sulme të
8 tilla sepse Bytyqi ka hequr referencën lidhur me luftën
9 speciale dhe elementët autonomist përpara se të përcillej në
10 dokumentarin e tij. Por, në fakt, ky argument shtrembëron
11 kuptimin e vërtetë që ka kjo provë.

12 Së pari, që i ka thënë këto fjalë Thaçi, në vetvete kjo
13 është e rëndësishme. Ky është një recitim personal i parimeve
14 kryesore në politikat kundër oponentëve dhe këto janë thënë
15 publikisht. Nyhi Bytyqi e pranoi kur dha dëshmi se qëllimisht
16 i ka prerë këto pjesë dhe tha se UÇK-ja kishte nevojë që të
17 kishte më shumë përkrahje nga të gjitha shtresat. Pra,
18 dëshmitari e dinte natyrën apo efektin negativ që do të kishin
19 këto fjalë, që është edhe më e rëndësishme nëse merr parasysh
20 që Nyhi Bytyqi e ka inkurajuar Thaçin ta bëjë fjalimin e tij
21 më diplomatik dhe këtë na e konfirmoi vetë kur ka dhënë dëshmi
22 dhe ka thënë që kjo provë është version i më diplomatik i
23 fjalëve të Thaçit. Pra, origjinali ka qenë edhe më keq.

24 Siç e ka përshkruar dëshmitari në faqen 381, në provën
25 1264_ET, kur pa skriptin përpara se ky që pamë në ekran i tha:

1 "Kur lexova fjalinë e parë nuk më pëlqeu, sepse që në
2 fillim të kësaj paraqitje publike ishte shumë ekstremist në
3 mënyrën e të shprehurit; por thërriste tradhtarë të gjithë ata
4 që nuk ishin kyçur në UÇK dhe ata që nuk e përkrahnin UÇK-në."

5 Së dyti, dhe më e rëndësishme, mesazhi i Thaçit kundër
6 luftës speciale edhe elementëve autonomistë është theksuar
7 edhe më tej nga Shtabi i Përgjithshëm në forma të ndryshme, në
8 forma të tjera. Të marrim një shembull më konkretisht. Më 1
9 nëntor 1998 drejtorja e policisë ushtarake pranë Shtabit të
10 Përgjithshëm lëshon Deklaratën për Shtyp numër 4, është
11 diskutuar shumë herë kjo deklaratë gjatë gjykimit. Është
12 deklarata për shtyp ku flitet për arrestimin e Cen Deskut dhe
13 Jakup Kastratit që ishin akuzuar se bashkëpunonin me
14 bashkëpunëtorët e ekzekutuar Ramiz Hoxhën dhe Selman Biniqin.
15 Foli, në fakt, z. Tieger tashmë për këtë, por drejtorja e
16 policisë ushtarake e justifikoi arrestimin e Deskut e të
17 Kastratit duke thënë se ata ishin në koordinim të vazhdueshëm
18 me Agim Krasniqin, një anëtar i presidencës së LDK-së,
19 kryesisë së LDK-së që shërbimi i zbulimit të UÇK-së e njihte
20 si një inspirues të luftës speciale kundër UÇK-së dhe një
21 nismëtar të policisë autonome në Kosovës. Lufta speciale.
22 Autonomistët. Ja pra i dëgjojmë sërish. Dhe kjo ka ndodhur
23 pikërisht dy ditë pasi z. Thaçi i ka thënë të njëjtat gjëra
24 përpara ekranit, dhe tani kjo lidhet në mënyrë të
25 drejtpërdrejtë me krimet që janë kryer në përputhje me

1 politikat që kishin kundër oponentëve.

2 Mesazhet që ka dhënë Thaçi janë një kontribut për krimet
3 e kryera dhe paraqitja e tij e parë, në fakt, është pjesë e
4 provave që tashmë i kemi pranuar. Këto përpjekje duhen parë
5 edhe në raport me mohimin që u ka bërë Thaçi krimeve, siç
6 është rasti i incidentit që e diskutoi z. Lawson ku Thaçi
7 gënjeu Frederick Abraham ballë për ballë për dy personat
8 serbë, dy gazetarët serbë të ndaluar e të keqtrajtuar, dhe tha
9 që ata janë trajtuar në mënyrë të rregullt.

10 Mund të shihni më shumë incidente në paragrafin 950, 955
11 të dosjes sonë, sidoqoftë, mënyra si Hashim Thaçi përpigjet të
12 manipulojë momente të caktuara tregon pikërisht se duhet të
13 jemi të kujdesshëm kur të pranojmë dëshmitë e dëshmitarëve
14 ndërkombëtarë sa i takon rolit të Thaçit, komandës apo
15 kontrollit në UÇK edhe në Qeverinë e Përkohshme në vija më të
16 përgjithshme. Ndërkombëtarët nuk e dinin se ai mund të
17 kërkonte që të lëvizeshin këta persona edhe t'i çonin në
18 Drenoc. Ai nuk e dinte se ai kishte rivendosur Ramush
19 Haradinajn si komandant të zonës së Dukagjinit dhe kishte
20 zëvendësuar Tahir Zemajn. Ai nuk e dinte se ai mund të bënte
21 emërime ushtarake si ky që do të shohim aktualisht në ekran,
22 që është Dëshmitari 04744.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari, në fakt, e sqaroi këtë
25 pikë të fundit.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "Dëshmitari: Po ne kemi qenë në situatë lufte ..."

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kur e pyesin Thaçin për këtë
4 emërim ZPS-ja ai sërish gënjen, mohon që ka ndodhur diçka e
5 tillë edhe madje pretendon ai nuk e di fare kush është
6 dëshmitari 04744. Këtë mund ta shihni në faqet 4, 5, të provës
7 P739.5_ET.

8 Ajo që nuk kuptojnë James Rubin, Wesley Clark dhe
9 ndërkombëtarë të tjerë është që Thaçi ishte i aftë të maskonte
10 atë çka po ndodhte në realitet dhe kjo ndikoi në botëkuptimin
11 e tyre për të kuptuar vërtetë se si funksiononte UÇK-ja.
12 Veçanërisht Rubin dhe Clark treguan që nuk kishin kurrfarë
13 interesi për të kuptuar se çfarë ndodhte në realitet dhe
14 besonin se puna e tyre ishte në anën e duhur të historisë dhe
15 nuk u përballën me atë çka po dëgjon tashmë ky Trup Gjykues
16 dhe për të cilën duhet të marrë vendimet përkatëse.

17 Vendimet e tyre, në fakt, nuk ishin as në përputhje as me
18 standardet ligjore ndërkombëtare sa i takon kontrollit
19 efektiv. Kryekomandanti i identifikuar i UÇK-së mund të mos të
20 ketë qenë në gjendje të ushtrojë komandën sikurse ushtrisë së
21 Shteteve të Bashkuara apo NATO-s, po as kishte nevojë ta bënte
22 këtë. Paragrafi 613 i dosjes sonë flet për shumëllojshmërinë e
23 hierarkisë të cilat janë të mjaftueshme për të konstatuar
24 përgjegjësinë eprorë sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare
25 ku janë cituar dënimet për administratorët, një roje civile e

1 një kampi burgu pa emërime formale, një zyrtar i medias edhe
2 një drejtor i një fabrike çaji, madje. Paragrafët vijues të
3 dosjes sonë flasin për treguesit e kontrollit efektiv dhe
4 citojnë edhe japin referencat përkatëse për evidencat që
5 tregoj se cila hierarki përputhet me standardin ligjor për
6 secilin nga të akuzuarit.

7 Mbroytja e Thaçit mbështet shumë në përshtypjet e
8 dëshmitarëve të vet. Por ata nuk kishin informacionet bazë për
9 t'u marrë parasysh. Dhe rrjedhimisht këto opinione nuk duhet
10 të kenë asnjë peshë.

11 Së fundi, në paragrafin 621 të dosjes, Mbroytja e Thaçit
12 pretendon se z. Thaçi nuk kishte asnjë detyrim t'u referonte
13 krimet ndërkombëtarëve sepse ata ishin tashmë në dijeni.

14 E lemë mënjanë dhe pretendimin se ndërkombëtarët ishin
15 autoritetet kompetente. Parashtrimi në vetvete është i pabazë.
16 T'i referosh veprat penale autoriteteve kompetente është një
17 masë e domosdoshme dhe e arsyeshme sepse ato do duhet të
18 hetojnë apo të ndëshkojnë krimet në rrethanat e asaj kohe.
19 Këtë mund ta shini në paragrafin 1933 të aktgjykimit të apelit
20 Popovic dhe të tjerë. Ky referim padyshim që do të kishte
21 dhënë kontributet e veta. Oficeri i KFOR-it, amerikanin Steven
22 Russell dha dëshmi, këtë mund ta shikoni në transkript 18772,
23 18773 se ishin përpjekur t'i hetonin krimet që kishin ndodhur
24 përpara se të mbërrinte KFOR-i dhe se kanë marrë informacione
25 relevante në lidhje me to.

1 Të akuzuarit e kishin për detyrim t'u referonin krimet e
2 vartësve të tyre çdo autoriteti kompetent të disponueshëm
3 asokohe. Autoritetet kompetente si KFOR-i, UNMIK-u dhe TPNJ-ja
4 ishin të gjitha ekzistuese asokohe dhe referimi i krimeve
5 sigurisht që do të kishte pasur frytet e veta. Çfarëdolloj
6 informacioni për krimet që kanë ndodhur do të ishte i dobishëm
7 dhe nuk mund t'i shfajësojmë për përgjegjësinë penale që
8 kishin sepse duhet t'i kishin referuar krimet tek autoritetet
9 kompetente.

10 Tani kalojmë te Kadri Veseli i cili njihet ndryshe me
11 nofkën Luli. Përpara sesa të vijojmë me këtë të akuzuar ne e
12 dimë që në fillim fare do të duhet që të kushtojmë kujdes kur
13 bëhet vlerësimi i argumenteve të Veselit dhe, për të qenë i
14 sigurtë, duhet kushtuar kujdes me të gjitha ekipet e
15 Mbrojtjes kur ata flasin për provat e paverifikuara.

16 Rregulla 140(4)(a) e përcakton këtë nocion për këtë
17 Gjykatë. Në të parashikohet që:

18 "Shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm ose në një
19 masë vendimtare në:

20 "(a) deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka
21 pasur mundësi ta pyesë."

22 Ndërkohë në rregullën 139(3) gjithashtu parashikohet që:
23 Trupi Gjykues nuk vendos kushtin ligjor të konfirmimit për
24 verifikimin e veprave penale apo veprimeve kriminale nën
25 juridiksionin e Dhomave të Specializuara në vartësi të

1 rregullës 140(4).

2 Megjithatë, Mbrojtja e Veselit argumenton në paragrafët
3 37 deri në 42 të dosjes së saj që një vendim fajësie nuk mund
4 të mbështetet vetëm në prova dytësore, që është një kategori
5 shumë e gjerë provash sesa deklaratat e dëshmitarëve. Një
6 "deklaratë dëshmitari" është një term i parashikuar në skemën
7 statutore që është diskutuar shumë shpesh gjatë këtij gjykimi
8 dhe ata kanë detyrime të posaçme për nxjerrjen e dokumenteve,
9 kërkesa për pranimin, si dhe aspekte të veçanta gjatë
10 shqyrtimeve.

11 Kur një dëshmitar vjen në gjykatë dhe kur jep dëshmi
12 lidhur me provat dytësore ose për atë çfarë ka dëgjuar nga
13 palë të treta, ky rregull nuk zbatohet përgjithësisht sepse
14 këta janë dëshmitarë ose deklaratat dëshmitarësh dhe si
15 rezultat duhet që të testohet ose të verifikohet
16 mbështetëshmëria e këtyre dëshmimeve. Ndërkohë Mbrojtja e Vesit
17 argumenton që nuk duhet që të mbështetet në deklaratat të
18 tilla, duke u mbështetur në paragrafin 69 në aktgjykimin e
19 apelit të Haraqija dhe Morina. Ndërkohë që dhoma e apelit e
20 TPNJ-së në paragrafin 62 thotë si më poshtë dhe këtu citoj:

21 "... jo të gjitha provat që vijnë si prova dytësore mund
22 të konsiderohen si të pavërtetuara ose të pambështetëshme. Në
23 të vërtetë si çështje ligjore lejohet që të bazohet një vendim
24 dënimi mbi provat rrethanore ose provat dytësore, por duhet
25 kushtuar vëmendje secilës prej rrethanave përkatëse."

1 Kjo përkon gjithashtu me rregullën 139(3) dhe gjithashtu
2 me konstatimet e panelit të apelit në paragrafët 329 deri në
3 330 të aktgjykimit të apelit të Shalës.

4 Provat dytësore të cilat janë ofruar nga dëshmitarë që
5 japin dëshmi, si të tilla, nuk bien nën fushën e veprimit të
6 rregullës 140(a). Kjo është e vërtetë gjithashtu edhe për
7 provat jo gojore të pranuar nga Trupi Gjykses. Kjo është e
8 vërtetë dhe për pranimet e të akuzuarve të mbështetura dhe në
9 deklaratat e tyre të cilat mbështeten në prova të tilla. Kjo
10 parashikohet dhe mund të gjendet më shprehimisht në vendimin e
11 Karadzic në paragrafin 452.

12 Qëndrimi ynë është që në këtë çështje nuk është e
13 nevojshme që të mbështetemi vetëm ose deri në një masë të
14 madhe në ndonjë deklaratë të dëshmitarit kur të akuzuarit nuk
15 kanë pasur mundësi që të marrin në pyetje dëshmitarët. Dhe
16 Ekipet e Mbrojtjes po e zgjerojnë, po e shtrijnë më tepër këtë
17 nocion përtej çështjeve dhe përtej rregullave mbi të cilat
18 punon DHSK-ja.

19 Si me të gjithë të akuzuarit e tjerë, shumë aspekte të
20 përgjegjësisë individuale të Kadri Veselit janë diskutuar
21 tanimë. Kemi diskutuar me përgjegjësitë e tij të zbulim-
22 kundërzbulimit, kemi diskutuar lidhur me anëtarët e
23 inteligjencës që ai ka pasur nën përgjegjësinë e tij gjatë
24 luftës dhe përfshirjen e tij të drejtpërdrejtë në krime. Ne e
25 kemi përmendur dhe më herët këtë citim të z. Veseli më

1 përpara. Megjithatë dua që të bazohemi dhe të përqendrohemi në
2 një tjetër aspekt të këtij citimi që keni në ekran:

3 "Në fakt, ne i kemi pasur përgjegjësitë tona gjatë gjithë
4 kohës së luftës në periudhën 1992-1998. Kemi pasur Shtabin e
5 Përgjithshëm, kemi pasur shtabin operacional të UÇK-së po
6 ashtu. Ne nuk kemi pasur detyra të veçanta po të gjithë kemi
7 bërë çfarë kemi mundur të bëjmë. Jemi përfshirë në udhëheqje,
8 logjistikë, inteligjencë sepse rrethanat ishin të tilla."

9 Sikurse u theksua dje nga z. Tieger, ky është një pranim
10 i qartë i vendimmarrjes kolektive. Por tani le të
11 përqendrohemi pak tek koha kur janë bërë këto komente. Veseli
12 këtu po flet për përfshirjen në udhëheqje, në logjistikë dhe
13 në inteligjencë që prej 1992-shit kur e ka bërë këtë
14 deklaratë. Edhe përpara sesa të bëheshin takimet themeluese të
15 1993-shit të UÇK-së, të cilat i diskutuam më herët, i takon që
16 Veseli ka qenë i përfshirë në udhëheqje dhe në veprimtari
17 inteligjence.

18 Mbrojtja e Veselit argumenton në paragrafët 16 dhe 116
19 deri në 117 të dosjes së tyre se Kadri Veseli nuk ka qenë
20 asnjëherë anëtar i LPK-së, por kjo nuk na përkon me dëshmitë e
21 marra. Përveç atyre që kanë konfirmuar që Veseli ka qenë
22 anëtar i LPK-së si, për shembull, Dëshmitari 04748 në
23 transkript në faqen T3512, Xhavit Haliti në faqen 3 të provës
24 P01857 dhe Rexhep Selimi në faqen 3 të provës P00761.7_ET, ju
25 mund të shikoni këtu një dokument të historikut të LPK-së që

1 është përgatitur nga Emrush Xhemajli, i cili është ish-
2 sekretari i përgjithshëm i LPK-së dhe që ka qenë në pozicion
3 të tillë që e dinte se si funksiononte LPK-ja. Xhemajli e
4 identifikon Kadri Veselin, Thaçin, Fatmir Limajn, Shukri Bujën
5 dhe të tjerë, si pjesë të një liste të personave të njohur në
6 mes të vitit 1998 si aktivistë me përvojë të LPK-së në
7 diasporë.

8 Pra, cilat janë metodat e LPK-së mbi zbulimin-
9 kundërzbulimin që Veseli ka qenë i përfshirë që prej vitit
10 1992? Sipas fjalëve të Dëshmitarit W04748 në transkript në
11 faqen T4177 dhe këtu citoj:

12 "Që metodat operative të Lëvizjes Popullore të Kosovës në
13 atë kohë, ato të cilat kanë marrë në dorë më pas UÇK-në,
14 metoda e tyre ishte që ata përpara sesa hiqnin dikë nga skena,
15 ata e akuzonin këtë person si bashkëpunëtor dhe kështu me
16 radhë."

17 Dhe dëshmitari shtoi se "ata të cilët nuk respektonin
18 Lëvizjen Popullore të Kosovës ishin personat të cilët do të
19 vuanin pasojat përkatëse, kjo ishte situata dhe kështu
20 ndodhte."

21 Në provën P02863, Emrush Xhemajli shpjegon se LPK-ja
22 gjithashtu ka prodhuar, ka bërë një punë prej katër volumesh
23 lidhur me strategjinë dhe taktikat e tij. Ballinat ose faqet
24 kryesore të këtyre katër volumeve janë pjesë e provave
25 gjyqësore. Në Volumin I mbulohet puna që ka bërë dega e

1 kundërzbulimit të LPK-së dhe çfarë mendohej që të bënte ajo:

2 "Në kohën e përshtatshme duhet të bëhet e qartë për të
3 gjithë popullsinë se askush nuk duhet të mendojë që kriminelët
4 do të mbeten të pazbuluar ose që do t'i kursejmë ata".

5 "Hetimet kryhen po ashtu në ata elementë që dyshohen që
6 kanë bashkëpunuar dhe qëllimi është që të zbulohen tradhtarët
7 e kamufluar dhe spiunët."

8 "Ekipet e klandestinëve mund të organizojnë, mund të
9 kryejnë aksione të ndryshme si vrasje spiunësh dhe
10 tradhtarësh."

11 Liridon Kosova është një tjetër shembull i të njëjtave
12 metoda që kemi parë dhe në komunikata në materiale që kishin
13 të bënin me zbulim-kundërzbulimi si prova P074 dhe P890 dhe që
14 kemi dëgjuar gjithashtu nga dëshmitarët të tillë si W04748,
15 W04747 apo çfarë i ka thënë Sokol Bashota TPNJ-së.

16 Mbrojtja e Veselit mbështetet në një papërputhshmëri të
17 datës së botimit të Liridon Kosovës të 1993-shit, por kjo në
18 vetvete nuk ndryshon deklaratën e Emrush Xhemajlit që është
19 provë në këtë proces gjyqësor lidhur me ekzistencën, dhe jo
20 vetëm kaq, por edhe gjithashtu përmbledhjen e detyrave të
21 zbulim-kundërzbulimit të cilat janë në përputhjet me dëshmitë
22 e tjera që keni pranuar në çështje. Argumenti në
23 poshtëshënimin 215 të dosjes së Veselit që Emrush Xhemajli ka
24 mohuar autenticitetin e Liridon Kosovës është i papërshtatshëm
25 dhe është çorientues sepse mbështete ekskluzivisht në prova të

1 pa verifikuara. Faqet e cituara në parashtrimet e Mbrojtjes
2 nuk janë pjesë e dokumentacionit të provave të kësaj çështjeje
3 dhe mbi to nuk mund të mbështetet Trupi Gjykses.

4 Tani të shohim kompetencat e Kadri Veselit dhe çfarë
5 lidhje ka pasur ai mbi anëtarët e NKP-së dhe instrumentet e
6 Shtabit të Përgjithshëm.

7 Sabit Geci dhe lidhja e tij me Veselin janë trajtuar nga
8 folësit e mëparshëm. Megjithatë le t'i kthehemi një shembulli
9 edhe më të hershëm ku mund të shihni se çfarë roli ka pasur
10 Veseli për emetimet.

11 Prova P67 diskuton se si Xhemë Gashi dhe Mahir Hasani
12 janë vendosur nga Shtabi i Përgjithshëm si komandant dhe
13 zëvendëskomandant i Drenocit në pranverën e vitit 1998.
14 Mbrojtja e Veselit e përshkruan këtë raport si tërësisht të
15 pambështetshëm në paragrafin 554 të dosjes së saj, pavarësisht
16 se ata kanë thënë "qartësisht një raport nga shtabi i
17 Drenocit" dhe kjo thuhet në transkript në faqe T4054. Në çdo
18 rast kjo provë materiale konfirmohet nga autorizimi i tij që e
19 ka vendosur Mahir Hasanin në Drenoc, gjë e cila është gjetur
20 në shtëpinë Jakup Krasniqit.

21 Dëshmitari W4753 konfirmoi se Xhemë Gashi dhe Mahir
22 Hasani ishin përgjegjës në Drenoc. Dhe të dy, W04748 dhe
23 Bislir Zyrapi, konfirmuan se ky është personi që quhet "Bis"
24 këtu dhe e bënë të qartë që Shtabi i Përgjithshëm i ka vendosur
25 këta dy persona të jashtëm në krye të njësisë lokale të

1 Drenocit. Dhe jo çdo kush në Shtabin e Përgjithshëm, sepse siç
2 mund ta shikoni këtu në provën P607, që është një intervistë e
3 nëntorit 1999 nga Bislum Zyrapi, këtu bëhet e qartë se kush i
4 ka bërë këto emërime këtu thuhet:

5 "Sikurse e thashë, Mahir Hasani ishte me mua, po dëgjonte
6 me kujdes propozimet e mia ku unë po filloja të jepja detyra
7 për t'u realizuar sepse kisha filluar emërimin me zyrtarë të
8 ndryshëm në zona të ndryshme në Kosovë. Pas kësaj unë i
9 propozova Hashimit, Lulit dhe Sokolit që Mahir Hasani duhet të
10 ishte dhe duhet të vazhdonte të qëndronte një oficer në këtë
11 zonë."

12 Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi personalisht janë të
13 përfshirë në këto emërime komandantësh. Këto janë aktivitete
14 shumë të diskutuara, kemi transkriptin 11602 dhe 11603. Dhe
15 Veseli në këtë rast nuk është vendi -- nuk është jashtë
16 shteti, ai nuk është i shkëputur nga këto ngjarje por ai është
17 pjesë e vendimit që i ka vendosur këta persona për të
18 mbikëqyrur operacionin e torturës dhe z. Tieger gjithashtu në
19 dokumentin që ju tregoi më herët, ju tregoi shenja të
20 inteligjencës së shtabit lokal të Vrrinit që bashkëpunonin me
21 policinë ushtarake të Drenocit. Çfarë ka ndodhur pas këtyre
22 emërimeve mund të gjendet në seksionet që kanë të bëjnë me
23 vendet e krimeve në Drenoc dhe në Malishevë të dosjes tonë.

24 Ndërkohë që tani dua t'i kthehem dy viktimave në Drenoc
25 të cilat janë diskutuar përgjithësisht edhe më përpara.

1 Megjithatë për të qenë më konkret do kërkoja që të
2 kalonim në seancë private për rreth pesë deri në dhjetë
3 minuta.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
5 kundërshtime? Në qoftë se nuk ka kundërshtime, le të kalojmë
6 në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

18 jemi në seancë të hapur.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

20 vijoni, Prokuror.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

22 Ne mund të shohim përfshirjen e drejtpërdrejtë të Kadri

23 Veselit në krimet e ngritura në aktakuzë edhe sa i takon

24 ndalimit të Milan Mitrovic. Në paragrafët 515 dhe 998 të

25 dosjes sonë diskutohet se si Veseli ka transferuar këtë person

1 të keqtrajtuar në Kleçkë. Raporti i KVM-së P4052 thotë që
2 bashkëbiseduesit e UÇK-së i kanë konfirmuar KVM-së pak pasi
3 është kapur personi në fjalë që ata po e mbanin Mitrovic dhe i
4 kanë thënë atyre dhe këtu citoj "Që po prisnin udhëzime prej
5 komandës më të lartë lidhur me këtë person". Në këtë raport
6 diskutohej se Mitrovic është ndaluar në Kleçkë me shënimin
7 "Shtabi kryesor Luli", ngjitur me të.

8 Veseli ka dhënë një deklaratë të mëparshme ku ka thënë që
9 ka qenë në afërsi të Kleçkës kur Mitrovic është transferuar.
10 Ky referim mund të gjendet në provën P787, në paragrafët 47 në
11 faqen 13. Një dëshmitar që ka dhënë dëshmi ka thënë, ky ishte
12 një dëshmitar që është mbajtur në Kleçkë me Mitrovic dhe ka
13 thënë në faqet 45 të provës P1134 që ai dhe persona të tjerë
14 në qeli me të janë rrahur keqazi. Mbrojtja gjithashtu ka pasur
15 mundësinë që të marrë në pyetje këtë dëshmitar dhe Naser
16 Krasniqin sa i takon Milan Mitrovic dhe kjo e gjitha ka
17 ndodhur përpara sesa të merremi me dëshmitë e dëshmitarëve
18 W04839, W04747, W03875 apo në modelin më të gjerë, praktikën
19 më të gjerë të ndalimeve në Kleçkë.

20 Mbrojtja e Veselit thjesht e ka gabim kur thotë në
21 paragrafin 600 të dosjes së saj që Dëshmitari W04839 është e
22 vetmja provë dhe e vetmja provë vendimtare kundër Veselit
23 lidhur me këtë incident.

24 Dhe Kadri Veseli ka ende shumë më tepër informacion sa i
25 takon krimeve të kryera edhe përtej atyre në të cilat ai ka

1 qenë personalisht i përfshirë.

2 Në korrik të 1998 dhe, në fakt, kjo është diçka që e
3 përmendi z. Tieger dje, Dëshmitari W02144 u takua me Kadri
4 Veselin dhe Hashim Thaçin. Dëshmitari paralajmëroi lidhur me
5 rrëmbimet dhe ndalimet e pretenduara të UÇK-së nga ICRC-ja,
6 nga kontaktet që kishte me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar në
7 Malishevë, ndërkohë që Thaçi i tha që UÇK-ja ishte një ushtri
8 e rregullt dhe që respektonte Konventën e Gjenevës.

9 Kjo është thënë konkretisht dhe këtu citoj:

10 "Nuk më kujtohet konkretisht se çfarë i thashë Thaçit por
11 unë nuk kam pretendime specifike lidhur me krime të veçanta
12 sepse nuk kisha prova konkrete të prekshme. Megjithatë, unë e
13 ngrita këtë aspekt në terma të përgjithshëm dhe fola lidhur me
14 pretendimet e ndalimeve dhe rrëmbimeve të raportuara
15 gjerësisht në kontekstin e qasjes së Kryqit të Kuq
16 Ndërkombëtar."

17 Veseli është pjesë e kësaj bisede. Mbrojtja e Veselit
18 kundërshton specificitetin ose detajet e informacionit të
19 dhënë në paragrafin 641 të dosjes së vet, por dëshmitari ngre
20 çështje të ndalimeve dhe të rrëmbimeve të UÇK-së të cilat
21 ishin gjerësisht të raportuara në atë kohë dhe këto probleme i
22 ka ngritur me këta dy persona duke u mbështetur në qasjen e
23 Kryqit të Kuq Ndërkombëtar tek të ndaluarit. Sikurse është
24 vendosur nga dhoma e Apelit të TPNJ-së në paragrafin 28 të një
25 aktgjykimi të vet, informacioni që i është dhënë të akuzuarve

1 dhe njoftimi i tyre duhet që të ketë qenë mjaftueshmërisht
2 alarmues për të justifikuar hetime të mëtejshme lidhur me atë
3 çfarë ndodhte në realitet.

4 Mosangazhimi i Kadri Veselit për të parandaluar dhe për
5 të ndëshkuar krimet në rolet që ka mbajtur në Shtabin e
6 Përgjithshëm në njësine e zbulim kundërzbulimit është një
7 kontribut sa i takon akuzave të ngritura në aktakuzë për NKP-
8 në si dhe nuk ka përmbushur as detyrat e tyre si një epror i
9 përgjegjshëm. Mungesa e tij në Kosovë nuk e ndryshon situatën.
10 Veseli mund të ushtronte kompetencat e veta në Kosovë kudo që
11 të ishte dhe kurdo që të dëshironte.

12 Në provën P1449, Pal Refsdal shkruan lidhur me një darkë
13 që ka pasur në Bruksel me Thaçin (Gjarprin) dhe Veselin
14 (Lulin) në janar të vitit 1999. Refsdal thotë që iu ka treguar
15 atyre lidhur me një vizitë të planifikuar të ministrit të
16 jashtëm norvegjez Knut Vollebaek në Kosovë. Rafsdal shkruan si
17 më poshtë:

18 “‘Ju të dy e dini që Norvegjia është drejtuese e OSBE-së
19 këtë vit’, i thashë në një ton të rëndë. ‘Ministri i Jashtëm
20 Vollebaek është në Shqipëri sot e do të shkoj në Kosovë në tre
21 ditë’.

22 “Ndalova ose bëra një pauzë të shkurtër për dy, tre
23 sekonda, për të theksuar rëndësinë e asaj çfarë do të thoja më
24 pas.

25 “‘A nuk do ishte mirë që ju të ishit në UÇK dhe ta

1 takonit atë atje?’

2 “Ata e panë njeri-tjetrin në sy dhe folën ca fjalë në
3 shqip. Pastaj Gjarpri u ngrit, mori telefonin e tij mobile dhe
4 u kthye mbrapsht pasi bëri telefonatën.

5 “Ai tha, ‘Unë mund të shkoj në Likovc. Ne do të sigurojmë
6 që ai të takohet me dikë nga udhëheqja’. Ai u ul dhe ne
7 vazhduam përsëri bisedën.”

8 Pra, ne e dimë nga dëshmitë që ky është informacion i
9 saktë sepse e dimë se çfarë ka ndodhur në takimin në Likovc
10 kur ka shkuar Vollebark atje. Refsdal po ashtu përmend dhe
11 tetë ushtarët e ushtrisë së armatës jugosllave, pra,
12 incidentin me këta tetë ushtarë dhe thotë që kjo bëhet një
13 çështje ndërkombëtare ndërmjet kohës nga darka në Bruksel deri
14 në vizitën e ministrit të jashtëm. Kur Vollebaek kthehet
15 takimi që kishte me UÇK-në është regjistruar dhe kjo jepet në
16 faqet e para të provës P182, kështu që kjo është diçka e cila
17 është gjetur gjithashtu edhe në një shënim në shtëpinë e
18 Rexhep Selimit.

19 Veseli dhe Thaçi mund të komunikojnë që prej jashtë
20 shteti kurdo që të dëshironin që të komunikojnë. Ata ishin në
21 gjendje ta bënin këtë gjë në çast, madje edhe në një mjedis
22 restoranti. Ata kanë pasur kontroll dhe kur kanë qenë jashtë
23 vendi, jashtë Kosove dhe kanë pasur mundësi që të parandalonin
24 dhe të ndëshkonin raste apo krime të tilla në qoftë se ato
25 ndodhnin.

1 Rexhep Selimi -- të nderuar Gjykatës, dëshironi ndoshta
2 të bëni ndonjë pushim tani?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
4 gjysëm ore pushim tani. Prisni një sekondë se më duket sikur
5 gabova.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Është ora 10.00.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kisha
8 gabim.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Dje keni dëgjuar për punën e
10 Rexhep Selimit në gjithë Kosovën për të mbikëqyrur dhe për të
11 zbatuar mes të tjerave edhe politikën kundër kundërshtarëve.
12 Por le të fillojmë tani me deklaratat e Rexhep Selimit dhe
13 intervistat e tij nëpër media.

14 Është e rrallë të shihet një dosje përfundimtare ku
15 mohohen gjëra që vetë klienti i ka thënë, pra, mohohen nga
16 Mbrojtja e tij. Rexhep Selimi prezantonte, paraqiste një
17 version të romantizuar të UÇK-së në paragrafin 57. Ata flasin
18 për ekzagjerime që janë pjesë e brendësishme e qenësishme e
19 komenteve të tij publike dhe kjo është në paragrafin 327.
20 Intervista e tij e dhënë Zërit në tetor të 1999 shpjegohet dhe
21 largohet, shmanget në paragrafin 59 si diçka që është asgjë më
22 shumë sesa mbështetje e thashethemeve.

23 Ajo që Mbrojtja e Selimit pranon është se gjërat që
24 Selimi thotë lidhur me UÇK-në ilustrojnë aftësinë e tij për të
25 kontribuar në krimet për të cilat akuzohet. Ne pranojmë se

1 deklaratat e Rexhep Selimit dhënë ZPS-së dhe mediave duhet të
2 vlerësohen me kujdes, megjithatë nuk ka bazë për t'i hedhur
3 poshtë ato menjëherë dhe në tërësi. Përkundër, në të kundërt
4 një vlerësim i kujdesshëm tregon konfirmim domethënës në
5 shkallë të gjerë të pikave relevante të shumta.

6 Fillojmë me një shembull të drejtpërdrejtë. Sulmi i
7 koordinuar ndaj stacioneve të policisë i shtatorit 1997
8 pasqyrohet në Komunikatën 36. Mbrojtja e Selimit e përshkruan
9 këtë komunikatë si "një shembull klasik i propagandës" në
10 paragrafin 304 të dosjes së tyre. Por pse? Rexhep Selimi ishte
11 jashtëzakonisht i qartë se ai e planifikoi këtë sulm. Siç mund
12 ta shihni këtu. Në intervistën e tij dhënë Zërit:

13 "... vendosëm të koordinonim sulmet tona, siç ishte dhe
14 rasti me katërmëdhjetë sulmet e datës 11 shtator 1997. Unë
15 isha përgjegjës për koordinimin e këtyre sulmeve. Isha
16 përgjegjës për këtë operacion në nivel të Kosovës së bashkë me
17 shokët e tjerë, por kam patur rol udhëheqës në koordinimin e
18 këtyre sulmeve."

19 Sylejman Selimi konfirmoi pjesëmarrjen e tij në të
20 njëjtin sulm në T24927 deri në T24928 dhe Mbrojtja e Selimit
21 nuk i bëri pyetje këtij dëshmitari. E vetmja gjë e ekzagjeruar
22 këtu është pretendimi për ekzagjerim. Rexhep Selimi u caktua
23 përgjegjës për goditjen e koordinuar më të madhe që UÇK-ja
24 kishte bërë deri në atë pikë dhe Komunikata 36 pasqyron këtë
25 sulm. Ai pastaj është personi që flet në paraqitjen e parë

1 publike të UÇK-së më vonë në 1997. Tregues nga koha, periudha
2 kohore para aktakuzës konfirmoi rëndësinë e Selimit.

3 Selimi vepron përmes pozitive që ai mban gjatë periudhës
4 së mbuluar nga aktakuza për të bashkëndarë qëllimin e
5 përbashkët kriminal dhe për t'i kontribuar atij. Këtë mund ta
6 shihni në gjuhën që ai përdor edhe përpara se të shikoni atë
7 duke rrahur një të ndaluar me një tub plastik dhe duke marrë
8 pjesë në kryerjen e krimeve të tjera.

9 Më herët folëm për atë që Thaçi i kishte thënë LDK-së dhe
10 FARK-ut në raportin e shtabit rajonal Liria. Selimi ishte
11 gjithashtu jashtëzakonisht i qartë mbi ndjenjat që ai kishte
12 apo si ndihej për këto grupe duke thënë që "Shtabi i
13 Përgjithshëm nuk e kishte njohur dhe nuk do ta njihte kurrë
14 këtë vijë institucionale, parlamentin, presidentin ..."

15 Në T17261-17262 dhe T17289, një dëshmitar i ZPS-së tregon
16 se si Selimi i tha atij, po citoj, "Do t'i vras me duart e mia
17 të gjithë ata që janë me Rugovën".

18 Kur Ekrem rexha, komandant Drini, u raportoi
19 ndërkombëtarëve se viktima që është pjesa që është në
20 aktakuzë, Ymer Xhafiqi ishte marrë, një komandant i UÇK-së
21 pyet Rexhep Selimin lidhur me këtë person. Reagimi i Selimit
22 ishte "Ai nuk është këtu", "Nuk kemi lidhje me këtë çështje"
23 dhe pastaj "Ai duhet të merret me mu. Do ta vras personalisht
24 Ekrem Rexhën, Drinin". Ky shkëmbim mund të shihet në T8768 në
25 faqen 18 të P00492.3. Këto janë kërcënime në qoftë se

1 ngatërroresh me Rexhep Selimin, në qoftë se e kundërshton apo
2 nxjerr në pah atë që po ndodhë.

3 Fakti se Selimi mund të ushtrojë kontroll efektiv mbi
4 njerëzit si Drini kjo mund të shihet në përfshirjen e tij të
5 drejtpërdrejtë në heqjen e tij, largimin e tij si komandant i
6 zonës së Pashtrikut në fillim të 1999. Siç e shpjegojmë ne
7 dhënë paragrafin 405 dhe 407 të dosjes sonë, ky vendim nuk u
8 mor në një situatë boshllëku por në një kontekst të një
9 mosbesimi në rritje të Shtabit të Përgjithshëm për ushtarët
10 profesionistë siç ishin Drini dhe ata që perceptoheshin apo
11 mendohej se ishin LDK apo mbështetës së FARK-ut.

12 Bislim Zyrapi, Dëshmitari W04769, W04737 dhe dëshmitarë
13 të tjerë e implikojnë Rexhep Selimin në këtë vendim.
14 Argumentet e Mbrojtjes së Selimit në përgjigje në paragrafët
15 446, 451 të dosjes së tyre përqendrohen në pjesët teknike dhe
16 motivet që nuk ndryshojnë asnjë lidhur me sa i takon
17 përfshirjes së Selimit.

18 Për shembull, Mbrojtja e Selimit përpiqet të shpjegojë
19 dhe të largojë, të ulë rëndësinë e provave të Bislim Zyrapit
20 mbi bazën se ai nuk e dinte, nuk e njihte procedurën e saktë
21 të caktimit të personelit që u bë në vijim të zëvendësimit të
22 Drinit. Por ne e dimë se Rexhep Selimi ishte në komisionin e
23 personelit, të stafit nga prova P1109. Dhe Zyrapi ishte i
24 qartë në pjesën e transkriptit të cituar ku ai thotë "u
25 zëvendësua sepse në atë kohë kishte kërkesa të përsëritura që

1 komandant Drini të hiqej nga ajo pozitë” dhe Zyrapit shton se
2 Rexhep Selimi kërkoj në vazhdimësi dhe me këmbëngulje heqjen e
3 tij.

4 Selimi kishte aftësinë dhe informacionin për të trajtuar
5 sjelljen e vartësve të tij dhe ai ndërmoi hapa për të hequr
6 dikë si komandant Drini por jo dikë si Sylejman Selimi, i cili
7 ishte emëruar nga Rexhep Selimi dhe Shtabi i Përgjithshëm
8 vetëm për të kryer krime me njerëzit e tij në Likoc. Rexhep
9 Selimi nuk bën asgjë për të ndaluar kushëririn e tij
10 Sylejmanin dhe provat për praninë e Rexhepit në mesin e të
11 ndaluarve të keqtrajtuar në Likoc i dha atij dhe më shumë
12 informacion për të ndërhyrë. Por Drini u hoq dhe Sylemani u bë
13 komandant i përgjithshëm. Mekanizmi i llogaridhënies është
14 komplet i kthyer mbrapsht. Dhe kjo është e bërë në mënyrë të
15 qëllimshme.

16 Shikojmë tani çështjen e ashtuquajtur Krojmir në fillim
17 të majit 1999. Ky rast kishte të bënte me katër policë ushtarë
18 të UÇK-së nën Haxhi Shalën të cili u përfshi në ndalimin dhe
19 keqtrajtimin e personave. Haxhi Shala ishte vetë
20 drejtpërdrejtë i përfshirë në krime të mëdha për të cilat
21 janë ngritur akuza, siç mund të shihet në paragrafin 800, 801
22 të dosjes sonë. Selimi vjen në Kleçkë, kërkon dosjen dhe
23 pastaj liron oficerët e policisë ushtarake. Dëshmitari W04743,
24 anëtar i shërbimit të zbulimit që ishte në atë kohë, i
25 raporton pastaj këto zhvillime Kadri Veselit. Provat për këto

1 ngjarje janë mbledhur, shkruar në paragrafin 252 të dosjes
2 sonë. Rexhep Selimi duke pasur mundësi të lirojë policë
3 ushtarakë të UÇK-së që dyshoheshin për krime ilustron
4 autoritetin e tij në UÇK-në dhe mosushtrimin nga ana e tij e
5 përgjegjësi për të mos liruar -- për të liruar persona,
6 viktimat të ndaluar në mënyrë të gabuar apo për të ndëshkuar
7 personat që kanë kontribuar në NKP.

8 Fakti që Rexhep Selimi është më shumë se një person që
9 lufton në luftë, mund të shihet në mënyrën se si vartësit e
10 tij ankohen ndaj tij.

11 Shohim shënimet e një takimi në të cilin Selimi mori
12 pjesë dhe që Mbrojtja përpiqet ta paraqesë si një *coup* nga
13 komandantët e zonave. Po të shohim në këto shënime P00182,
14 shihet se si komandantët e zonave ankohen për mënyrën se si
15 Sokol Bashota që nuk është në nivel të detyrës dhe Jakup
16 Krasniqi, i respektuar por jo personi i duhur për postin,
17 pozitën që ka, që janë zëvendëskomandantë është çështje
18 shqetësuese për ata dhe se si Shtabi i Përgjithshëm ka
19 shpërfillur kërkesat e tyre lidhur me këtë. Edhe ne duhet të
20 ishim konsultuar, kjo është ankesa e tyre. Dhe kush është
21 fajtori për shpërfilljen e kërkesave të tyre dhe
22 moskonsultimin e tyre? Sami Lushtaku e bën këtë të qartë:

23 "Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë
24 përgjegjës për këtë situatë në të cilën gjendemi në këtë
25 moment."

1 Në këto faqe, Sylejman Selimi është kaq i zëmëruar për
2 faktin se kërkesat e tyre janë shpërfillur dhe ata nuk janë
3 konsultuar saqë i thotë Shtabit të Përgjithshëm që në qoftë se
4 nuk bëhet diçka ai nuk do të raportojë më, gjë që e bën të
5 qartë se ai i kishte raportuar deri në atë moment atyre. Po në
6 të njëjtat shënime ku Sylejman Selimi shton "Hashim, Kadri dhe
7 '10' kanë kontribuar luftës që në fillim. '10' është njëri
8 prej atyre që ka rrezikuar më shumë gjatë luftës". '10', siç e
9 dimë, është Rexhep Selimi.

10 Mbrojtja e Selimit argumenton në paragrafët 441 dhe 445
11 të dosjes së tyre se nuk ka prova të autorësisë së këtij bllok
12 shënimesh që të jetë paraqitur dhe nuk i është paraqitur asnjë
13 dëshmitari gjatë gjyimit. Në mesin e shumë dëshmitarëve të
14 cilëve u tregua ky bllok shënimesh gjatë shqyrtimit gjyqësor
15 janë W04739, W04744, W04752, W04401 dhe W04290.

16 Me Dëshmitarin W02144, ne kemi përdorur dhe këtë video të
17 Rexhep Selimit që shkruan shënimet e tij në mars 1999 në
18 takimin në Terstenik të marsit të 1999 në të njëjtin libër.
19 Dëshmia relevante është në faqen 16094, 16097. Unazat, lidhja,
20 pjesa lidhëse e bllokshënimeve në video përputhet me atë që
21 shihet në P00182 dhe përmbajtja e shënimeve përputhet me
22 përmbajtjen e mbledhjes apo takimit.

23 Angazhimi i Rexhep Selimit në përfshirja e tij në
24 Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët mund të shihet
25 përfundimisht në sjelljen e tij si ministër i rendit publik.

1 Selimi përballet në mënyrë të drejtpërdrejtë me aktivitetet e
2 paligjshme të policisë dhe konfrontohet për këtë nga Gjenerali
3 Mike Jackson. Në P02525, Jackson thekson në lidhje me
4 autoritetin e ligjshëm të KFOR-it se nuk mund të ketë
5 kundërshtime të paligjshme ndaj kësaj force të ligjshme. Z.
6 Selimi i kërkohet që të garantojë ndërprerjen dhe pushimin e
7 aktiviteteve të paligjshme të policisë ushtarake.

8 Mbrotjtja e Selimit kundërshton në paragrafin 471 dhe 472
9 të provave të tyre se kjo provë materiale është e pasaktë
10 sepse nuk ka krijuar një forcë policore të tillë. Dhe, në
11 fakt, kjo është e pavërtetë dhe kundërshtohet ndër të tjera
12 prova si në vijim, nga komunikata e Ministrisë së Rendit
13 Publik ku përcaktohet dhe përshkruhet mandati i policisë në
14 kundërshtim të tërësishëm me Rezolutën e Këshillit të
15 Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244.

16 Zyrtari i policisë, kartat identifikuese të zyrtarëve të
17 policisë të Ministrisë së Punëve të Rendit Publik të
18 nënshkruara nga Rexhep Selimi dhe të sekuestruara nga shtëpia
19 e tij, përfshirë kjo e komandantët të Ajvaz Berisha, komandant
20 i ish-njësisë speciale të Shtabit të Përgjithshëm. Kartat e
21 tjera janë gjetur në shtëpinë e Selimit, siç është ajo e ish-
22 zëvendëskomandantit të policisë ushtarake në Drenoc, Selim
23 Krasniqi. Mbajtësit e këtyre kartelave kishin leje që të
24 mbanin armë dhe të identifikonin persona, të legjitimonin ata
25 dhe t'i sillnin në polici. Selimi, në dëshminë e tij në TPNJ

1 dhe intervistën e ZPS-së, e përmendur në poshtëshënimin në
2 2210 të dosjes sonë, konfirmoi se ai dhe Ministria e Rendit
3 Publik i kanë lëshuar këto kartela, në gusht të 1999-s, i kanë
4 tërhequr këto kartela pasi u është kërkuar të bënin këtë gjë
5 nga KFOR-i. Por Ministria e Rendit Publik vazhdoi t'i nxirrte
6 këto kartela, t'i lëshonte, siç mund të shihet nga karta e
7 identitetit e shtatorit 1999 për Milaim Latifin, një ish-police
8 ushtarak që i lidhur me ndalimin dhe keqtrajtimin e
9 kundërshtarëve.

10 Dhe, natyrisht, kemi provën P01539, një raport edhe këtu
11 i sekuestruar nga shtëpia e Rexhep Selimit, nga komandanti i
12 policisë ushtarake të Karadakut Fatmir Mehmeti, i cili ankohet
13 për operacionin e KFOR-it në qendrën e ndalimit në Gjilan, për
14 të cilin Steven Russell dëshmoi se gjetën aty një dhomë
15 torture.

16 Rexhep Selimi nuk mund t'i shmanget materialeve që ai ka
17 në posedim dhe fjalëve që ai ka thënë në të kaluarën, të
18 gjitha këto e paraqesin atë që është pjesëmarrës në tërësi dhe
19 me vullnet në Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët.

20 Dhe në fund Jakup Krasniqi. Përpara se të kalojmë tek
21 vetë Krasniqi, paraprakisht donim të trajtonim parashtrimet
22 lidhur me ndihmën dhe inkurajimin në Pjesën 6 të dosjes së
23 Mbrojtjes së Krasniqit. Ajo që argumentohet aty është gabim
24 material.

25 Mbrojtja e Krasniqit argumenton paragrafin 771 se

1 Prokuroria nuk mund të përdorë, të mbështetet në të njëjta
2 akte të pretenduara apo mosveprime në të cilat është
3 mbështetur për të përshkruar kontributin domethënës dhe të
4 rëndësishëm në një ndërmarrje kriminale të përbashkët të
5 pretenduar dhe t'i trajtojë ato si prova të ndihmës dhe
6 inkurajimit. Autoriteti për këtë propozim apo argumentim është
7 paragrafi 91 i aktgjyqimit të apelit në RPNJ Kvocka dhe të
8 tjerët dhe mbështetja, përpjekja për t'u mbështetur në këtë
9 çështje tregon se është e nevojshme që të bëjmë një dallim
10 alternativ nga shpalljet e fajësisë alternative.

11 Të gjitha mënyrat e përgjegjësisë të paraqitura në këtë
12 çështje - NKP I, NKP III, ndihmë dhe inkurajim dhe përgjegjësi
13 e lartë - janë paraqitur në aktakuzë si alternativë. Ne kemi
14 kërkuar që të bëhen konstatime për të gjitha këto, por vetëm
15 një prej tyre mund të jetë bazë për shpalljen fajtor për të
16 njëjtën grup faktesh. Gabimi në Kvocka ishte thelbësisht
17 shpallja fajtor për ndihmë dhe mbështetje në ndërmarrjen
18 kriminale të përbashkët që pastaj u rrëzua në apel mbi bazën
19 se dhomat nuk mund të grumbullojnë mënyrat alternative të
20 përgjegjësisë në këtë mënyrë. Por kjo është faza ku bëhet
21 fjalë për shpalljen fajtor apo jo.

22 Në paragrafët 102, 101 në apelin e aktgjyqimit të Dhomes
23 së Apelit të TPNJ-së në Naletilic dhe Martinovic, Dhoma e
24 Apelit vlerësoi argumentin e Mbrojtjes se ngritja e akuzave në
25 formë alternative bazuar në të njëjtën sjellje ishte dëmtuese.

1 Gjykata konfirmoi se ngritja e akuzave në formë alternative
2 mbi bazën e të njëjtës sjellje ishte në përgjithësi e
3 lejueshme pastaj më vonë konstatoi se është e lejueshme në
4 rrethanat e asaj çështjeje, po të asaj çështjeje. Ne jemi të
5 lejuar, besojmë, që të përdorim dhe të mbështetim të njëjta
6 veprime në të dy NKP-të të ndihmës dhe mbështetjes për këtë
7 kontekst. Kjo është mënyra e akuzës alternative bazë.

8 Shoh që është ora për pushim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
10 një pushim tani por nuk deshëm që të ndërprisnim në fjalimin
11 tuaj.

12 Kthehemi në orën 11.00.

13 --- Pauza fillon në orën 10.20

14 --- Seanca fillon në orën 10.55

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
16 vazhdoni.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

18 Sa i përket provave kundër Jakup Krasniqi, procesverbali
19 i çështjes është i mbushur me deklaratat e tij nxitëse, me
20 vendime që i ka marrë në rolin e tij në kuadrin e Shtabit të
21 Përgjithshëm dhe materialet e shumta që janë gjetur në
22 shtëpinë e tij të cilat konfirmojnë atë që ka shkruar në
23 librat e tij dhe çfarë i ka thënë TPNJ-së lidhur me rolin që
24 ka pasur dhe veprimet që ka bërë.

25 Dhe ajo që ka bërë është më shumë sesa i përket një

1 zëdhënësi që tregon lidhur me rolin e tij në kuadrin e NKP-së
2 dhe kontrollit efektiv.

3 Siç ju tha nga z. Pace më herët, në librin e tij Jakup
4 Krasniqi e pranon që e ka shkruar këto rregulloret përkatëse
5 të ushtrisë, së bashku me urdhrat për policinë ushtarake që të
6 ishte e pamëshirshme ndaj të gjithë atyre që janë kundërshtarë
7 dhe sabotojnë luftën çlirimtare. Siç është paraqitur në
8 paragrafin 126 të dosjes sonë, versione të shumta të këtyre
9 dhe të rregulloreve të tjera janë gjetur në shtëpinë e
10 Krasniqit, siç pritej të ishte situata me një përpilues të
11 këtyre materialeve.

12 Krasniqi ka luajtur rol në emërimet zyrtare, përfshirë
13 dhe përmes pranimi në provën materiale P189_ET.1, pranimin,
14 pra, që Ahmet Isufi me propozimin e tij u emërua si komandant
15 i zonës së Karadakut. Dhe faqja për këtë është U015-8876.
16 Është i njëjti Ahmet Isufi i cili reagoi përmes heshtjes kur
17 iu tregua nga KFOR-i i Shteteve të Bashkuara dhoma e torturës
18 në Gjilan.

19 Krasniqi ka mbikëqyrur edhe sektorin ligjor duke përçuar
20 emërimin e Sokol Dobrunës dhe e ka informuar atë lidhur me
21 burgjet e UÇK-së në Kleçkë, Kervasar, Lladrovë dhe më vonë
22 duke e këshilluar Dobrunën se si të fliste me ndërkombëtarët
23 lidhur me pesë civilët e vjetër serbë të cilët ishin rrëmbyer.
24 Dhe provat për këto mund të gjenden në paragrafët 250, 553 dhe
25 567 të dosjes sonë. Megjithatë, përveç autoritetit mbi

1 Dobrunën, ai nuk ka bërë asgjë tjetër për të bërë të mundur,
2 Krasniqi nuk ka bërë asgjë për të bërë të mundur që gjykata
3 ushtarake të mund të gjykonte edhe krimet për të cilat bëhet
4 fjalë.

5 Mbrojtja e Krasniqit përpiket që të shfajësojë vendimet
6 dhe urdhrat që ka marrë Krasniqi duke pretenduar se ato
7 thjesht ishin formë, zyrtarizëm i vendimeve të mëhershme apo i
8 vendimeve kolektive të cilat ai thjesht po i përçonte. Mirëpo
9 këto argumente nuk e ndryshojnë faktin që ai ishte pjesë e
10 këtij grupi që i merrte këto vendime kolektive, që nuk ishte
11 thjesht përçues mesazhi.

12 Në paragrafin 727 të dosjes së tyre, në veçanti, Mbrojtja
13 e Krasniqit i hedh poshtë disa prej firmave apo nënshkrimeve
14 të Krasniqit si "një proces burokratik dhe jo si një autoritet
15 i komandantit". Dhe është i njëjti Ekip Mbrojtës që në
16 paragrafin 120 mbështetet në provat e James Rubin se Shtabi i
17 Përgjithshëm ishte thjeshtë një kasolle me nja dy divane. Pra,
18 Shtabi i Përgjithshëm ishte aq primitiv që mund të bënte çdo
19 gjë dhe kishte një burokraci të atillë saqë të kishte nevojë
20 për firmat e Krasniqit me qëllim që të ecte puna e tyre.

21 Mbrojtja e Krasniqit po kështu i ka thënë se ZPS-ja i ka
22 përzgjedhur deklaratat e Krasniqit, duke mos paraqitur dhe
23 kontekstin për t'i kuptuar ato në mënyrën e duhur.

24 Megjithatë, kjo është thjesht një refuzim për të parë si
25 ishte realiteti në të vërtetë. Nuk ekziston argument konteksti

1 i cili mund ta shpëtojë Jakup Krasniqin kur thotë se "Ata të
2 cilët i kemi rrëmbyer janë lajmëruar përmes listës apo janë
3 raportuar si të ekzekutuar". Nuk ka fare paqartësi në
4 paralajmërimin publik për bashkëpunëtorët që do të vriteshin
5 në qoftë se "do të vazhdonin të ecnin në rrugën e gabuar". Në
6 paragrafin 419 të dosjes së tyre, Mbrojtja e Krasniqit i
7 reziston përpjekjeve për ta kontekstualizuar këtë deklaratë si
8 një pranim i vrasjeve të së shkuarës. Por pyetja së cilës i
9 përgjigjet Krasniqi lidhur me vrasjen e bashkëpunëtorëve të
10 cilët do të vazhdonin në rrugën e gabuar është si më poshtë:
11 UÇK-ja shpesh është vlerësuar se ishte një organizatë
12 terroriste. Përse atëherë vret shqiptarët paqësorë?

13 Interpretimi që i bën Mbrojtja e Krasniqit komenteve të
14 klientit të tyre pas paraburgimit të vëllezërve Savelic në
15 fillim të vitit 1999, që diskutohet në paragrafët 384 deri në
16 388 të dosjes së tyre, është një shembull tjetër i ilustrues i
17 spikatur i mosparjes së tërë kontekstit të deklaratave. Po t'i
18 shihni në tërësi bisedat e Jakup Krasniqit lidhur me këta
19 vëllezër të paraburgosur, pretendimi i Krasniqit që ata nuk do
20 të duhej të ishin rrëmbyer është pjesë e një dialogu të gjatë
21 se si ta shpjegojmë këtë gjë përpara komunitetit ndërkombëtar.

22 Pa e transmetuar publikisht këtë diapozitiv, ne mund të
23 citojmë një pjesë të asaj që është thënë dhe ta bëjmë këtë në
24 seancë publike.

25 Krasniqi po bisedon me Sokol Bashotën. Bashota pyet:

1 "Çfarë të bëjmë, çfarë t'u them atyre? Ata ishin civilë
2 apo çfarë?

3 "J - Më beso, nuk di se çfarë duhet t'i thuash."

4 Atëherë Bashota komenton lidhur me faktin që Drini kishte
5 informuar ndërkombëtarët lidhur me këta druvarë, duke thënë që
6 "Drini na ka futur në pozitë të vështirë kur e ka liruar
7 njërin prej tyre". Dhe vetëm si përgjigje ndaj kësaj Krasniqi
8 thotë që:

9 "Ata nuk do të duhet të ishin rrëmbyer fillimisht, por do
10 të shohim tani se çfarë mund të bëjmë."

11 Kjo nuk është një kundërshtim i akteve kriminale. Po
12 është një diskutim se si të kontrollojmë dëmin e bërë tani që
13 janë kapur në këtë akt.

14 Ky kontekst po kështu edhe për të parë se si e ka
15 mbrojtur Mbrojtja e Krasniqit vrasjen e Ramiz Hoxhës dhe
16 Selman Biniqit para TPNJ-së.

17 Dhe këto mund të transmetohen.

18 Dhe këtë thotë lidhur me ekzekutimin e tyre:

19 "Unë mendoj se fjala 'ekzekutim' është shfrytëzuar në një
20 kuptim tjetër të kësaj fjale. Ata mund të jenë vrarë, sipas
21 informacionit që kam pasur, por janë, ka ndodhur një gjë e
22 tillë -- ata i kanë dhënë informacion kësaj force -- forcave
23 serbe në Malishevë."

24 Këta dy meshkuj kanë lidhje me paraburgimin e Cen Deskut
25 dhe Jakup Kastratit, siç u përmend më herët lidhur me P303.

1 Dhe ajo që paraqitet në ekran duhet parë pikërisht me atë që
2 Krasniqi i ka treguar TPNJ-së lidhur me bashkëpunëtorët në
3 provën P794, ku thotë dhe citoj:

4 "Këta njerëz, bashkëpunëtorët, ishin të shumtë dhe nuk
5 kanë marrë dënimin e duhur për atë që kanë bërë. Ata kanë qenë
6 në shërbim të regjimit të dhunshëm serb. Njerëz të tillë nuk
7 kanë merituar një fat më të mirë për shkak se i kanë shërbyer
8 regjimit më kriminal që është i njohur në Evropë që pas Luftës
9 së Dytë Botërore."

10 Nuk ka prova në procesverbal që Hoxha dhe Biniqi të kenë
11 marrë pjesë në aktivitete të kësaj natyre. W01365 dhe W04278
12 nuk mund të kenë qenë më të qartë se kjo gjë nuk ka qenë e
13 vërtetë. Megjithatë janë vrarë dhe kjo është bërë përmes
14 urdhrit të ekzekutimit që u gjet afër trupave të tyre, siç u
15 përmend nga z. Tieger pak më herët.

16 Mbrojtja e Krasniqit argumenton në paragrafin 53 të
17 dosjes së saj se dëshmia e Jakup Krasniqit në TPNJ duhet të
18 ketë peshën e duhur për shkak se ishte bërë e detyruar. Por
19 nuk përmendin që ky argument është bërë që në deklaratën e tij
20 të parë që në fillimet e paraqitjes së tij. Me vendimin e
21 F01917, të nderuar Gjykatës ju i keni hedhur poshtë këto
22 argumente. Më pas ka patur një apel të ndërmjetëm, i cili ka
23 gjetur se ka patur gabime të padëmshme përpara konstatimit që
24 nuk ka patur shkelje të parimit të mosinkriminimit dhe i ka
25 pranuar këto deklarata si prova materiale.

1 Mbroytja e Krasniqit nuk mund të argumentojë se pranimi i
2 këtyre deklaratave nuk mund të jetë objekt për t'u mbështetur
3 për shkak se do të shkelte të drejtat e tij për një gjykim të
4 drejtë.

5 Pohimet e Krasniqit lidhur me autoritetin e tij përpara
6 TPNJ-së, në P189, përputhen me provat. Krasniqi ka patur në
7 një deklaratë të UÇK-së shënime me shkrim dore në shtëpinë e
8 tij, ku thuhet në provën materiale P1447_ET se "duhet të
9 respektojmë hierarkinë me fanatizëm". P3765 është, përbëhet
10 nga shënime të një takimi që është gjetur në rezidencën e
11 Selimit ku Krasniqi thuhet të ketë thënë që "asgjë nuk duhet
12 nënshkruar pa miratimin e Shtabit të Përgjithshëm"

13 Këto nuk janë deklarata të kota. Shikoni se si e merr nën
14 kontroll situatën e negociatave të tetë ushtarëve të ushtrisë
15 jugosllave. Shikoni dhe rolin e tij lidhur me arrestimin e
16 Blerim Kuqit.

17 Përpjekjet e Mbroytjes së Krasniqit për të mos pranuar
18 nivelin e autoritetit që ka pasur klienti i tyre nuk përputhen
19 me tërësinë e provave të paraqitura. Në paragrafin 719 të
20 dosjes së saj, Mbroytja e Krasniqit, për shembull, argumenton
21 se "Prania e z. Krasniqi në Ditën e Flamurit më 28 nëntor 1998
22 nuk sugjeron praninë e një autoriteti".

23 Ta shohim këtë video tani.

24 [Luhet videoincizimi]

25 [Zëri]: "Të dashur ushtarë dhe eprorë, gëzuar Festën e

1 Flamurit.

2 "Rroftë Flamuri."

3 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të shohim referencën e hapur
4 të Jakup Krasniqit lidhur me luftën speciale në të njëjtin
5 aktivitet.

6 [Luhet videoincizimi]

7 [Zëri]: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi me shumë
8 fronte secili më i egër se tjetri, secili më finok se tjetri.
9 Luftoi kundër një makinerie të tërë ushtarake,
10 propagandistike, përballoi ofensiva ushtarake të papara pas
11 Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, përballoi një luftë
12 speciale të koordinuar nga jashtë e brenda dhe eci pandalshëm
13 përpara. Dhe çuditen miqtë dhe armiqtë me mbijetesën e
14 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me gatishmërinë dhe
15 vendosmërinë e saj luftarake. Qëllimi i armikut të të gjitha
16 ngjyrave ishte zhdukja e UÇK-së, eliminimi i saj nga jeta
17 politike që pastaj Kosovës t'i imponohet një zgjedhje e
18 parëndësishme mjerake, pacifiste apo gandiste."

19 Z. HALLING: [Përkthim] Hierarkia e UÇK-së nuk është
20 perfekte, por treguesit e kontrollit efektiv janë aty dhe të
21 dukshëm për të tërë.

22 Të nderuar Gjykatës, NKP-ja për të cilën janë ngritur
23 akuzat e kësaj çështjeje gjyqësore përbëhet nga një kombinim i
24 shpërndarjes i elementeve publike, i zbatimit të politikave, i
25 ekzekutimeve kriminale, kryesisht nga personeli i

1 inteligjencës dhe i policisë ushtarake. Secili prej të
2 akuzuarve ka pasur portofol në njërën prej këtyre aspekteve të
3 punës në Shtabin e Përgjithshëm dhe në Qeverinë e Përkohshme
4 për të realizuar objektivat e përbashkëta. Vendimet që e kanë
5 çuar më tej këtë synim kriminal dhe të cilat janë pjesë e
6 këtyre portofolave i përkasin secilit prej tyre. Disa prej
7 vendimeve që kanë nënshkruar i kanë nënshkruar, disa e
8 pranojnë që i kanë marrë, por që të gjitha janë ratifikuar
9 prej secilit prej të akuzuarve përmes vazhimit të rolit të
10 tyre në atë që është bërë edhe në emrin e tyre. Komunikatat në
11 të cilat kërkohej vrasja e bashkëpunëtorëve dhe vendimet e
12 marra për të ekzekutuar civilët serbë apo caktimet dhe
13 emërimet në nivelet më të larta të përgjegjësisë së anëtarëve
14 të NKP-së janë pjesë e kësaj, po kështu edhe vendimet për
15 vrasjen e serbëve civilë.

16 Është në përputhje të plotë me përgjegjësinë kriminale
17 individuale që individët të mbajnë përgjegjësi për rolin e
18 tyre brenda strukturave kolektive të cilat janë abuzuar për
19 kryerjen e krimeve. Të akuzuarit kanë krijuar një strukturë
20 kolektive të vendimmarrjes më pas kanë thënë fjalët, kanë bërë
21 emërimet, kanë marrë pjesë në krime dhe kanë bërë të mundur që
22 të vazhdojnë këto aktivitete penale kriminale me qëllim që të
23 merrnin dhe kontrollin e të tërë Kosovës. Ky nuk është fajësi
24 përmes shoqërimit. Por është përmes përkatësisë së qëllimshme.
25 Aktet dhe sjellja e tyre përcaktojnë se secili prej tyre ka

1 bërë, ka dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë ndërmarrje të
2 përbashkët kriminale për të cilat janë ngritur pikat e
3 aktakuzës.

4 Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Tani do t'ia jap
5 fjalën Prokurores së Specializuar West për të bërë edhe fjalën
6 mbyllëse.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
8 Prokurore, mund të vazhdoni kur të jeni gati për ta bërë këtë.

9 ZNJ. WEST:[Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,
10 znj. Administratore, të gjithë të pranishmëve në të këtë sallë
11 gjyqi.

12 Mbi 5.000 prova materiale janë pranuar dhe 28.000 faqe
13 transkript janë paraqitur këtu dhe kështu që procesverbali i
14 kësaj çështjeje gjyqësore është voluminoz. Aty përfshihet
15 dëshmia në sallë e më shumë se 130 dëshmitarëve, të cilët
16 dhanë dëshmi gjatë 147 ditëve të gjyqit. Gjykata po kështu ka
17 marrë parasysh edhe dokumentet shkresore apo deklaratat
18 shkresore të më shumë se 130 dëshmitarëve.

19 Ka qenë privilegj për mua dhe për zyrën që përfaqësoj që
20 të takoj shumë prej këtyre njerëzve të cilët i kanë përjetuar
21 këto ngjarje të përshkruara në këto prova. Njerëz, përfshirë
22 të akuzuarit, të cilët kanë luftuar për vendin e tyre kundër
23 vështirësive. Njerëzit të cilët kanë kontribuar në mënyra të
24 ndryshme që kanë qenë udhëheqës vendorë apo kanë shpërndarë
25 ndihma. Njerëz të cilët kanë dhënë mbështetje dhe kanë

1 mbështetur familje gjatë luftës. Njerëz të cilët kanë jetuar
2 për më shumë se 20 vite me pasojat e krimeve që kanë pësuar në
3 mënyrë të pakuptueshme, përfshirë edhe viktimat e krimeve për
4 të cilat janë ngritur aktakuzat e kësaj çështjeje gjyqësore.

5 Zyra ime ka punuar që atyre t'u jepet drejtësia dhe të
6 jepet llogari nga individët përgjegjës.

7 Këto përpjekje dhe ky procedim penal janë edhe pjesë e
8 parimit më të shenjtë të drejtësisë dhe të shtetit ligjor. Në
9 fakt, shteti i së drejtës gjatë kohëve më të vështira, kohëve
10 të luftës është i rëndësishëm.

11 Kanë kaluar shumë vite tashmë dhe ata të cilët kanë
12 humbur pjesëtarë të familjes kanë menduar se nuk do të kenë
13 drejtësi, por shteti i së drejtës nënkupton se askush nuk
14 është mbi të drejtën dhe mbi ligjin. Kjo do të thotë që edhe
15 njerëzit më të fuqishëm do të duhet të japin llogari. Ne
16 kërkojmë, mbi bazën e provave të paraqitura dhe të cilat e
17 vërtetojnë përgjegjësinë pa asnjë dyshim të arsyeshëm që të
18 akuzuarit të japin llogari dhe të jepet dënimi i duhur.

19 Të nderuar Gjykatës, faleminderit për mundësinë që të
20 flas para jush sot. Këtu përfundon edhe deklarata mbyllëse e
21 ZPS-së.

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, mund
24 të presim pas drekës nëse dëshironi ose mund të fillosh tani.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam i lumtur që të filloj tani,

1 nëse më lejoni ta bëj një gjë të tillë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju
3 lejojmë ta bëni një gjë të tillë.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Atëherë, kështu do të bëjmë.

5 Në Kosovë, në Serbi dhe në diasporë kudo në të gjithë
6 botën, ka njerëz të cilët zgjohen sot me dhimbje në trupin e
7 tyre, në mendje kanë keqardhje dhe humbje dhe në mungesë të
8 njerëzve të cilët i kanë dashur më shumë. Ata janë viktimat e
9 krimeve të kryera nga anëtarë të UÇK-së në 1998 dhe 1999. 155
10 prej tyre janë pranuar si viktima pjesëmarrëse të kësaj
11 çështjeje gjyqësore: Shqiptarë, serbë, romë. Dhe parashtimet
12 e mia do të dua t'i përqendroj në rastin e tyre dhe në emrin e
13 tyre.

14 Nuk është ekzagjerim të thuhet se këto krime kanë lënë
15 plagë të rënda dhe të shëmtuara në të gjithë globin. Mund të
16 thuhet që ishte e pashmangshme që lufta e UÇK-së për pavarësi
17 do të çonte në humbje jetësh njerëzore. Kjo është pasojë e
18 konfliktit dhe asgjë që mund të them unë nuk përbën gjykim
19 lidhur mbi të drejtat apo të padrejtat e kësaj lufte dhe nuk
20 është as vlerësim i UÇK-së në përgjithësi. Shumë prej
21 viktimave e kanë mbështetur UÇK-në. Një numër prej tyre kanë
22 qenë anëtarë të UÇK-së. Këtu nuk bëhet fjalë për të denigruar
23 këtë institucion, por bëhet fjalë për sjelljen e disa prej
24 anëtarëve të tij dhe pasojat në jetën e atyre të cilët unë i
25 përfaqësoj.

1 Ishte e pashmangshme që do të humbeshin jetë njerëzish.
2 Por a ishte e pashmangshme po ashtu që kjo luftë të çonte në
3 mizëri dhe në vdekjet për të cilat ky Trup Gjykues ka dëgjuar
4 kaq shumë tashmë? A ishte e pashmangshme që një luftë
5 çlirimtare të çonte në humbjen e lirisë për një numër kaq të
6 madh njerëzish apo që civilë nga të gjitha komunitetet të
7 torturoheshin dhe disa prej tyre të humbnin edhe jetën
8 ndërkohë që mbaheshin të parandaluar nga UÇK-ja?

9 Ju do të duhet të merrni vendim se përse kanë ndodhur
10 këto gjëra. Këto ngjarje a e kanë pasur burimin në trurin e
11 njerëzve të cilët dëshironin të merrnin pushtetin apo kanë
12 qenë ngjarje spontane dhe kanë ndodhur thjesht sepse udhëheqja
13 e UÇK-së nuk ka patur kontrollin e duhur, nuk ka patur mundësi
14 t'i kontrollojë? Është ky, sigurisht, një vendim me rëndësi
15 shumë të madhe për viktimat. Shumica prej të cilëve janë të
16 habitur dhe mbeten të habitur lidhur me atë që u ka ndodhur
17 vetë atyre.

18 Kam disa diapozitiva që me ndihmën e Sekretarit të
19 Gjykatës do të duhet t'i shohim, dhe ju lutem të kalojmë tek e
20 dyta. Që të gjithë këta diapozitivë mund t'i transmetohen
21 publikut.

22 Tre viktimave i është bërë e njëjta pyetje dhe i keni
23 dëgjuar gjatë dëshmisë së tyre dhe ata të tre kanë thënë të
24 njëjtën gjë: Përse më ka ndodhur mua kjo gjë? Mund të mendoni
25 që kjo është një pyetje e natyrshme që t'ju bëhet viktimave

1 dhe shumë viktima e kanë bërë këtë pyetje vetes së tyre gjatë
2 viteve që kanë kaluar që nga koha kur kanë presuar dëmin e
3 tyre. Pyetja tjetër përse nuk kam baba, vëlla, burrë apo nuk e
4 kam më djalin tim? Përse më duhet që unë të jetoj me ankth, që
5 të kem frikë nga çdo zhurmë e mundshme, të kem frikë nga
6 ëndrrat dhe të shqetësohem nga fakti që bota nuk është ashtu
7 siç duhet të ishte? Përse nuk më punojnë si duhet duart,
8 këmbët, krahët, sytë, veshët? Përse nuk mund të flas hapur
9 lidhur me atë që më ka ndodhur mua vetë? Përse mu desh mua që
10 të shkoj në një vend tjetër të huaj dhe të lija çdo gjë që kam
11 pasur dhe për të cilin kam pasur dëshirë prapa?

12 Përse i ka ndodhur një gjë e tillë atyre? Kjo është
13 pyetje me vlerë për secilin prej viktimave të kësaj çështjeje
14 dhe, në fakt, është dhe në thelb të kësaj çështjeje gjyqësore.
15 Përse, në vitin 1998 dhe 1999 në Kosovë merreshin njerëzit nga
16 shtëpitë e tyre nën kërcënimin e armëve apo ndaloheshin tek
17 një postbllok apo në një zyrë apo ndërkohë që vazhdoni punën e
18 tyre, përse njerëz të armatosur i merrnin ata me forcë dhe i
19 fusnin nëpër makina? Përse merreshin këta njerëz? Dhe pasi
20 janë marrë përse rriheshin, torturoheshin? Përse janë mbajtur
21 të ndaluar në kushte të pista dhe degraduese? Përse shumë prej
22 tyre nuk kanë qenë në gjendje që t'i shohin më shtëpitë apo
23 njerëzit e tyre më të dashur? Përse do të duhet të përfundonin
24 në varre të pashënuara që e shtonte edhe torturën për njerëzit
25 që kanë mbetur më pas?

1 Përgjigja mund të ketë forma të ndryshme. Shkaku kryesor
2 apo i menjëhershëm është dëshira e disa njerëzve brenda
3 ushtarëve të UÇK-së që të jenë mizorë dhe që të mos mbajnë
4 parasysh jetën apo mirëqenien e të tjerëve. Dhe kjo mund të
5 ndodhë për shkak se në nivel të caktuar ata e kanë parë
6 pretendimin se një i parandaluar ishte bashkëpunëtor apo që
7 ishte serb apo rom dhe e kanë parë këtë si një bazë të
8 mjaftueshme për të justifikuar sjelljen e tyre.

9 Perceptimi i vetvetes je duke rrahur një armik të
10 popullit duke qenë se je patriot vetë, mund të imagjinohet që
11 të jetë më e pranueshme për ndërgjegjen e një personi sesa të
12 mendosh se je thjesht torturuesi i një fermeri, mësuesi, i një
13 shitësi drush, studenti dhe e ke bërë këtë gjë tjetër jo për
14 ndonjë arsye tjetër sesa të pëlqen dhuna që ushtron.

15 Atë që nuk e kuptojnë apo që nuk e çajnë kokën fare, ata
16 të cilët kanë kryer këto krime është impakti që kanë në këto
17 viktima dhe fakti sesi këto krime janë shpërndarë dhe kanë
18 ndikuar në jetën e të afërme më të dashur. Ky është kontekst
19 të cilin e kanë dhënë viktimat dhe është i domosdoshëm. Përse
20 i dëgjojmë këto çështje gjyqësore në goftë se nuk e bëjmë këtë
21 duke patur parasysh vuajtjen e viktimave.

22 Këto çështje dhe kjo çështje gjyqësore, nuk janë thjesht
23 çështje studimore. Kjo aktakuzë nuk është një përshkrim i
24 thatë ligjor i akteve kriminale por bëhet fjalë për vende, për
25 kohë kur njerëzit kanë pësuar dëm të madh, dëm që i ka

1 ndryshuar ata dhe familjet e tyre. Duke pranuar që ka ndodhur
2 ky dëm, një trup gjykues është në gjendje që t'i dëgjojë të
3 thotë që vuajtja e viktimave nuk është anashkaluar edhe në
4 rast të një çështjeje gjyqësore të gjerësishme saç ishte kjo.
5 Por në fund, ajo që presim që të ndodhë është që viktimat të
6 kenë zërin e tyre dhe që zëri i tyre të jetë dëgjuar.

7 Dhe ndoshta do ishte kjo pika e duhur për të parë disa
8 prej përvojave të tyre dhe disa prej dëshmime që kemi dëgjuar.

9 Dhe ju lutem që të vendosim në ekran diapozitivin tjetër,
10 i nderua z. Sekretar.

11 Do të flas lidhur me disa lloje të dëmit të pësuar në
12 katër nënndarje. Së pari do të shohim paraburgimin dhe
13 keqtrajtimin. Viktimat e tërthorta dhe krimet e paraburgimit,
14 humbjen e personave të afërt të familjes, të dashur të
15 familjes, ekzilin, humbjen e shtëpisë dhe në fund do të flas
16 lidhur me rëndësinë e këtij gjyqi dhe diçka lidhur me të
17 ardhmen.

18 Po merrem me temën e parë, që ka të bëjë me paraburgimin
19 dhe keqtrajtimin.

20 Për një shqiptar, mënyra se si një shqiptar të gjendet në
21 një kamp paraburgimi të UÇK-së do të ishte që të etiketohet si
22 bashkëpunëtor apo për ndonjë arsye tjetër që të shihej si
23 kundërshtar. Për një serb apo për një rom ishte bazë e
24 mjaftueshme mund të ishte thjesht përkatësia entnike. Për disa
25 ky ishte një rrugëtim me një drejtim, udhëtim të cilit ata nuk

1 do ta përfundonin dot asnjëherë. Për disa të tjerë kjo ishte
2 një përvojë e zhdukjes për disa orë, disa për disa muaj në një
3 botë krejtësisht të panjohur në të cilën bashkëshoqëruesit e
4 vazhdueshëm ishin dhuna dhe mizëria.

5 Së pari, duhet të nënvijëzoj disa prej aspekteve të
6 viktimave shqiptare të cilët janë etiketuar si bashkëpunëtorë,
7 për shkak se dëmi që kanë pësuar ata dhe familjet e tyre është
8 krejtësisht i posaçëm dhe vazhdon dhe sot e kësaj dite dhe
9 duhet parë në kontekstin e plotë. Dhe do ta shoh këtë në katër
10 nënndarje dhe kjo është e para: Baza e akuzës së
11 bashkëpunimit.

12 Nga këndvështrimi i viktimave, politika e paraburgosjes
13 së bashkëpunëtorëve, që nga fillimi, ka pasur një mangësi
14 shumë të dukshme: Si e dini se kush është bashkëpunëtor? Si
15 përcaktohet një gjë e tillë në mungesë të një procesi të
16 njëmend ligjor? Në fakt, nuk janë bërë përpjekje serioze për
17 të identifikuar nëse një person ishte bashkëpunëtor. Njerëzit
18 janë rrëmbyer thjesht mbi bazën e asaj që ishte thjesht një
19 thashethem.

20 Është e vështirë të besosh që dikush mund të humbasë
21 lirinë dhe më pas jetën mbi një bazë të tillë, por ja kështu
22 ka ndodhur. Ky rrjet i kampeve të UÇK-së drejtohej mbi bazën e
23 prezumimit të fajësisë. Personat ndaloreshin për arsye krejt
24 absurde dhe në një mënyrë që duhet t'u garantonte -- ishte e
25 sigurt që do sillte padrejtësi. Më shumë se një viktimë

1 shqiptare ka folur për mënyrën se si i kanë trajtuar serbët në
2 komunitetin e tyre thjesht për marrëdhënie pune apo për arsye
3 të tjera dhe se si kjo u shndërrua në një bazë dhe u akuzuan
4 si bashkëpunëtorë. Dukej sikur aparati që merrte këto vendime
5 kërkonte në mënyrë aktive mënyra për të akuzuar dhe për të
6 ndaluar personat. Pra, kur u jep pushtet personave ata do ta
7 shfrytëzojnë në mënyrën më të keqe ndonjëherë.

8 Kishte shumë dyshime. Kështu filloi një valë ndalimesh në
9 këtë qoshe të botës me pasoja të tmerrshme për shumë persona.

10 Titulli i dytë sa i takon ndalimit dhe keqtrajtimit është
11 moshetimi i akuzave kundër të ndaluarve. Ky është një tipar që
12 është mbresëlënës në këtë kontekst, mënyra, pikërisht mënyra
13 se si i çonin në ambientet e ndalimit këta persona, nuk është
14 bërë asnjëherë përpjekje për të vërtetuar në fakt nëse një
15 person ishte vërtetë bashkëpunëtor apo ishte fajtor për ndonjë
16 vepër të caktuar penale. Fajësia ishte e prezumuar. Fokusi
17 ishte të rriheshin, të keqtrajtoheshin personat dhe
18 këmbëngulnin që ata të rrëfenin dhe të pranonin krime. Rrallë
19 herë u është dhënë ndonjë bazë për akuzën dhe rrallë herë u
20 është dhënë shansi që t'i përgjigjen.

21 Qoftë kjo përmes një gjesti për të zbuluar të vërtetën,
22 por edhe kur përpiqeshin të përgjigjeshin, kjo përgjigje
23 shpërfilllej nëse nuk ishte përgjigja që ata donin të dëgjonin.
24 Për shembull, Dëshmitari W02018 që u akuzua për një krim
25 specifik. Kur viktima e supozuar e krimit, në fakt, e mohoi

1 vetë, nuk bëri asnjë dallim. Personin e rrahën sërish.

2 Nëntitulli tjetër është: Mizoria e jashtëzakonshme që
3 treguan disa nga ushtarët e UÇK-së që ishin përgjegjës për të
4 gjithë të burgosurit e të gjitha etniciteteve.

5 Mizoria që kemi parë në këtë çështje gjyqësore ka qenë
6 ekstreme. Nuk mjaftonte të ndëshkoje personat thjesht duke i
7 burgosur, por thuajse në të gjitha rastet të ndaluarit, pra,
8 viktimat që unë përfaqësoj u trajtuan në mënyrë të tmerrshme
9 dhe mizore. Edhe nuk pati absolutisht proces të drejtë ligjor,
10 që në fakt është fillimi i hetimit të një akuze. Në fakt për
11 këtë foli Prokuroria dje, por unë dua të flas shkurtimisht me
12 disa shembuj që i kam marrë nga përvojat e viktimave në këtë
13 çështje.

14 Kemi dëgjuar personat që i kanë rrahur në ahure, të
15 rrethuar nga mbetje kafshësh, dhoma që ishin shumë të ftohta
16 në dimër dhe që vlonin nga vapa në verë, që të burgosurve nuk
17 u është dhënë ushqim dhe ujë dhe nuk u jepej asnjë informacion
18 sa do të zgjaste kjo përvojë kaq e keqe apo nëse do të dilnin
19 të gjallë prej saj. Kemi dëgjuar për viktimë që i kanë rrahur
20 me hekur të nxehtë, që i kanë urinuar, që i kanë hedhur kripë
21 në sy edhe mbi plagë, që i kanë rrahur në organet gjenitale
22 deri në pikën sa nuk ishin më në gjendje që të bënin fëmijë,
23 që i kanë tallur dhe i kanë ekzekutuar. Kemi dëgjuar për
24 rrahjet, për shumë e shumë rrahje.

25 Të ndaluarit rriheshin nga ushtarë të rinj, por edhe nga

1 figura të larta dhe të njohura si Sabit Geci, Xhemshit
2 Krasniqi edhe, nëse ZPS-ja ka të drejtë, madje edhe nga Rexhep
3 Selimi. Janë rrahur nga gra, nga të burgosur të tjerë që i
4 detyronin që t'i rrihnin, nga persona, nga grupe të ndryshme,
5 janë rrahur me shkopinj, me hekura, me shkopinj gome, me tuba,
6 me tyta armësh, me shkopinj bejsbolli dhe me çdo gjë që u
7 gjendej në atë kohë. Shumë syresh janë rrahur derisa kanë
8 humbur ndjenjat, disa janë rrahur disa herë brenda një dite
9 dhe disa me ditë e ditë me radhë.

10 Pse u trajtuan me një mizori të tillë?

11 Dëshmitari W0778 u trajtua për lëndime në dorën e tij në
12 bazën e KFOR-it. E kishin rrahur me shkopinj në Verban.
13 Doktorit që e pa plagën u befasua që diçka e tillë mund të
14 bëhej në shekullin e XX. Këtë mund ta gjeni në provën P1147.

15 Pra, nuk ishte e pazakontë që viktimat të thonin se
16 mendonin se do të vdisnin. Dhe e dinin se të tjerë, në fakt,
17 kishin vdekur në ambientet e ndalimit. Madje disa prej tyre
18 preferonin të vdisnin që të merrnin fund vuajtjet. Kush mund
19 t'i fajësojë? Unë nuk jam i sigurtë a ka ndonjë advokaci që
20 mund t'u jap drejtësi viktimave për atë çfarë kanë vuajtur në
21 këtë rast. Siç i kujtohet Trupit Gjykues ne kemi pasur edhe
22 aktekspertiza lidhur me këtë temë.

23 Ju lutem të kalojmë në diapozitivin tjetër.

24 Pra, kemi pasur ekspertë të fushës së shëndetësisë dhe
25 trajtuam torturën dhe çështjet e ndalimit dhe të viktimave dhe

1 krimet që kanë pësuar viktimat në këto raste. Pra, ndalimi
2 është një përvojat më të vështira njerëzore dhe ndalimi, siç
3 kemi dëgjuar, nga shumë, shumë viktima është diçka që shumë
4 persona e kanë përjetuar.

5 Kalojnë në diapozitivin tjetër.

6 Dhe në rrethana siç mund ta lexoni në diapozitivin
7 përpara se është veçanërisht relevant:

8 "... trajtimi i të burgosurve nga stafi i burgut gjatë
9 ndalimit është një nga elementët më të rëndësishëm të
10 zhvillimit edhe të vazhdimit stresit post-traumatik."

11 Dhe humbje e plotë kontrolli dhe varësi e plotë nga
12 personat që të kanë rrëmbyer edhe kjo e bën ndalimin
13 veçanërisht traumatizues. Këtë mund ta shihni në transkriptin
14 përkatës në faqet T26224, 223.

15 Natyra individuale e dhunës nga një person që të rrëmben
16 është një element i rëndësishëm që e dallon rrëmbimin apo
17 ndalimin nga ngjarje të tjera të jetës.

18 Ju lutem kalojmë në diapozitivin tjetër.

19 Ekspertët thanë se:

20 "... e dimë që trauma që i shkakton një person një
21 personi tjetër ka efekt më të thellë sesa përvoja traumatike
22 që shkakton një fatkeqësi natyrore."

23 Sipas nesh, 50 viktima në këtë rast janë mbajtur në
24 ambientet e ndalimit të UÇK-së. Përvojat e tyre të tmerrshme,
25 dhuna dhe keqtrajtimi që kanë pësuar duhet parë nën dritën e

1 raportit të ekspertëve. Ndalimi është përvojë shumë e
2 vështirë. Dhuna personale që përjeton personi dhe mënyra si u
3 trajtuan të ndaluarit nga stafi i burgut e shtoi dhe e bëri më
4 të rëndë sepse është elementi person me person kjo e bën kaq
5 të vështirë në këtë situatë.

6 Përvojat e tyre janë të shumta dhe unë nuk mund t'i
7 trajtoj të gjitha. I keni me shumë hollësi në dosjen tonë
8 përfundimtare, por unë do të diskutoj disa syresh.

9 Dëshmitari W02652 mësoi çfarë ishte keqtrajtimi si pjesë
10 e një grupi. "Kur një prej jush rrihet është sikur të rrihen
11 të gjithë njëkohësisht". Pra, ishte dhuna personale sërish.

12 Dëshmitari W03879 mësoi çfarë ishte të lidhnin ndërkohë
13 që të mbanin të ndaluar, që do të thotë që personat që të kanë
14 ndaluar mund të bëjnë çfarë të duan me ju, është një përvojë e
15 jashtëzakonshme që tregon se sa e vështirë është kjo se nuk je
16 në gjendje që ta luftosh, edhe këtë mund ta shihni në
17 transkriptin T6395.

18 Dëshmitari W04419 u kalua në rrymë elektrike me fytyrën
19 poshtë në dysHEME dhe i kujtohet se si i dridhej trupi teksa i
20 vendosnin korrentin në trup.

21 W04305 përshkroi se si pas lirimit pa trupin e tij,
22 mënyra si dukej trupi i tij i ënjtur, i mavijosur, aq sa u
23 frikësua.

24 Këto përvoja nuk duhet t'i ketë asnjë person dhe
25 sigurisht që ato lënë gjurmë të përjetshme si në mendje ashtu

1 edhe në trup.

2 Dhe tani do të kaloj tek tema e fundit lidhur me ndalimin
3 dhe keqtrajtimin që janë pasojat, pasojat që kanë pasur këta
4 tetë viktimat.

5 Disa persona nuk i kanë harruar kurrë këto krime që nga
6 momenti që ndodhën dhe deri tani. Ekspertët e shëndetit mendor
7 thanë se fjala që koha i shëron plagët, fatkeqësisht, nuk
8 mbështetet me hulumtime. Dhe, në fakt, kështu ka qenë për
9 shumë e shumë viktima në këtë çështje. Sigurisht, që kanë
10 pasur kanë qenë pasojat e menjëhershme si mavijosja, dhimbja
11 fizike. Dhe për disa prej tyre u desh kohë që t'ju shëroheshin
12 plagët dhe zbutej pak trauma që kishin pësuar. Ndonjëherë
13 ishte e nevojshme që të largoheshin nga bota.

14 Për shembull, Dëshmitari W01679 ka qëndruar me muaj të
15 tërë në shtëpi dhe jetonte vetëm si një kufomë që ecte. Këtë
16 mund ta shikoni në transkript dhe bëhet fjalë për viktimën V35
17 dhe V18.

18 Shumë viktima kanë pasur nevojë të trajtoheshin për shumë
19 e shumë vite dhe shumë syresh kanë ende pasoja sot e kësaj
20 dite.

21 Për të tjerë dhimbja fizike ishte gjëja më e pakët. Por
22 ishte dëmi psikologjik ai që vërtetë iu ndryshoi jetën.
23 Makthet, ankthi. Pamundësia për të fjetur. Sa shpejt acarohen,
24 nervozohen. Frika se dikush po të ndjek apo po të sheh. Frika
25 se bota nuk është më një vend i përshtatshëm për ty si person.

1 Edhe, sigurisht, për disa, fatkeqësisht, do të thotë që kanë
2 pasur nevojë të shtrohen në ambiente psikiatrike. Të tjerë
3 kanë menduar edhe vetëvrasjen. U është dashur të kenë mjekim
4 për një kohë të gjatë dhe të mjekohen për një kohë të gjatë.

5 Por janë historitë individuale që tregojnë më qartë
6 pasojat. Marrim si shembull Dëshmitarin 344. Ai na tha se i
7 kishin vrarë personalitetin. Se nuk mund të qëndronte më
8 vetëm, por as nuk donte të qëndronte me persona të tjerë. Ai
9 ishte gjithë kohën në vigjilencë dhe gjatë gjithë kohës
10 mendonte të tjerët janë mirë por unë nuk jam. Acarohej shpejt,
11 flinte keq, merrte kujdes psikiatrik, merrte ende mjekime.

12 Dëshmitari W04305 po ashtu nuk është më i lirë ndonëse
13 fizikisht e kanë liruar nga ambienti i ndalimit para 25
14 vitesh.

15 Kalojmë në diapozitivin përkatës ju lutem.

16 "Pa arsye kisha këto episode ça kam përjetu dhe më vjen
17 në mendje. Dhe më kujtohen të gjitha. Në ato momente e humbas
18 komplet arsyetimin dhe tensionohem shumë shpejt, kështu që
19 largohem nga personat, nuk dua të jem me grupe, dua të
20 shkëputem nga bota. Pra, dua të shkëputem në ato momente në
21 mënyrë që të qetësohem."

22 Dhe nuk është i vetmi person që e përjeton këtë. Ne kemi
23 pasur persona të tjerë të cilët na kanë treguar që kanë pasur
24 makthe dhe provat janë të qarta sa i takon ndikimit që mund të
25 ketë kjo në jetën e një personi. Përshkrimi është një individ

1 si papritmas, pa arsye, ajo që i bën, i kontrollon mendjen e
2 këtij personi, mendimet e këtij personi dhe ai humbet arsyen.

3 Ekspertë të shëndetit mendor na ndihmuan dhe na bënë një
4 përkufizim të kësaj përvoje sa i takon fanitjeve, fanepseve.

5 Pra, nuk e mendojnë dhe nuk e kujtojnë përvojën. Po në
6 fakt e ripërjetojnë sikurse po ndodh përsëri me të gjitha
7 elementët përkatës të saj. Pra, ndjejnë të njëjtën erë që ka
8 ndjerë asokohe. Ndjejnë të njëjtën dhimbje fizike në pjesë të
9 caktuara të trupit që, në fakt, janë goditur në kohën kur ka
10 ndodhur ngjarja. Dhe kjo e bën shumë shqetësuese nga pikëpamja
11 emocionale. Nëse dikush ka pasur një fanepsje dhe thotë që ju
12 kthehet në ato momente mund ta shikosh këtë person sa i
13 shqetësuar është dhe duhet shumë kohë që personi të rikuperojë
14 këtë dhimbje dhe të kuptosh që personi është mes dy botëve
15 edhe sesi personat ripërjetojnë atë që ka u ndodhur.

16 Një shembull tjetër për të ilustruar që koha nuk i shëron
17 plagët.

18 Dëshmitari W04781, të themi një burrë i fortë, trupmadh.
19 Dhe ai ju tha që ai kishte frikë nga errësira dhe flinte duke
20 parë derën për çdo rast se mos vinin këta burra, të njëjtët
21 burra që kanë marrë herën e parë dhe që i morën personat që
22 donte.

23 Këto janë kushte shqetësuese dhe shumë të rënda sepse kjo
24 do të thotë që disa viktimat nuk do të jenë dot kurrë të lirë
25 nga ajo që u ka ndodhur. Në përmbledhje mund të themi që

1 qendrat e ndalimit të UÇK-së, në fakt, janë pikërisht arsyeja
2 për sëmundjet e shëndetit mendor sikurse aso kohe ishin
3 ambientet ku u shkaktuan dhimbje fizike këtyre personave.

4 Kjo është pika e parë që doja të trajtoja. Pika e dytë,
5 tema e dytë janë viktimat e tërthorta të krimeve të ndalimit.
6 Kjo nuk është shumë e gjatë.

7 Dëmi që u shkaktua personave për shkak të ndalimit të
8 tyre sigurisht që u shtri dhe në marrëdhëniet e këtyre
9 personave. Dëshmitari W04870 ka qenë i pranishëm kur i morën
10 anëtarët e familjes. Edhe sot e kësaj dite vuan nga shumë
11 simptoma përfshirë fanepsjet dhe na ka dhënë një përshkrim të
12 detajuar kur ka dhënë dëshmi në këtë sallë gjyqi. Në fakt,
13 tregonte se si kishte fanepsje dhe gjatë rrugës kur po vinte
14 këtu u ndje keq edhe kur pa mantelet e zeza i krijonin
15 shqetësim sepse i kujtoheshin ata burrat që kishin ardh në mes
16 të natës të veshur me të zeza dhe që mbanin armë.

17 Dy shembuj të tjerë. Të dy viktima që na kanë dhënë
18 dëshmi të trishta se si ishte të takoje një afërmit e tu që
19 ishte në kampet e UÇK-së i ndaluar. Dëshmitari W04371 kujton
20 se ka parë babain të ndaluar. Dukej i trishtuar dhe i
21 tronditur. Dhe djali e pa në sytë e tij se ai po i kërkonte
22 ndihmë, por familja nuk mund të bënte asgjë. Edhe sot e kësaj
23 dite, Dëshmitari W04371 ka fanepsje të imazhit të babait të
24 tij kur shkon të flejë, këtë mund ta shikoni në transkriptin
25 përkatës T15277.

1 Dëshmitari W04811 po ashtu kujton se ka parë babain e saj
2 në ndalim. Ishte i lodhur, i uritur, i dobët, qante, s'e
3 kuptonte çfarë kishte bërë të gabuar. Të dy këta baballarë u
4 vranë. Jetët e fëmijëve të tyre janë të mbushura me kujtimet e
5 fundit të tyre edhe do vijojnë të jenë të tilla derisa të
6 vdesin dhe ata vetë.

7 Për të burgosurit që mbijetuan, familjet duhet të jetonin
8 me pasoja të ndryshme. Në rastin e Dëshmitarit W04733, për
9 shembull, nënkuptonte që familja priti një person të lënduar,
10 një person që nuk do të punonte më kurrë, që nuk do të ishte
11 më kurrë i qetë nga pikëpamja mendore pas përvojës së
12 tmerrshme të ndalimit. Një baba ndryshe, një bashkëshort
13 ndryshe, i dëmtuar, që kërkonte kujdes por nuk ofronte më
14 kujdes.

15 Tema tjetër është humbja e të dashurve. Kjo kategori dëmi
16 mbase duket më e lehta që për të cilën ne mund të ndjejmë
17 empati. Të gjithë mund ta imagjinojmë, mbase dhe disa edhe
18 kanë përjetuar çdo të thotë të humbasësh një person të dashur,
19 por nuk është kaq e thjeshtë. Pikësëpari dhe më e rëndësishmja
20 në këtë rast është padrejtësia e asaj që ka ndodhur. Kemi parë
21 dhe kemi trajtuar natyrën arbitrare të ndalimeve dhe vrasjet
22 nuk ishin më pak arbitrare në vetvete edhe më pak shfajësuese.

23 Kemi 84 viktimë që janë të afërm të viktimave të vrasjeve
24 që janë pjesëmarrës në këtë çështje gjyqësore. Brenda këtij
25 grupi, 20 viktimë janë anëtarë familjesh të personave që janë

1 zhdukur dhe për këtë ka ngritur akuza Prokuroria. 66 të tjerë
2 kanë pasur të dashurit të burgosur dhe s'janë parë më kurrë
3 ose përfundimisht janë zhdukur, por për këta nuk janë ngritur
4 akuza për zhdukje me forcë.

5 Çfarë i lidh të gjithë këto viktima, pavarësisht nëse
6 janë serbë apo shqiptarë të Kosovës, apo nëse janë viktima të
7 zhdukjes me forcë apo nëse janë thjesht viktima vrasjeje apo
8 burgosjeje, ajo që i lidh është që kanë vuajtur një formë të
9 caktuar dëmi, nuk e dinë saktësisht çfarë u ka ndodhur
10 personave të tyre të dashur, pse ndodhi dhe kush ishte
11 përgjegjës për ta.

12 Një deklaratë e përbashkët nga Këshilli i Evropës vitin e
13 shkuar theksoi pikërisht natyrën e këtij dëmi.

14 Ju lutem vendosim diapozitivin 9 në ekran.

15 "Zhdukjet me forcë nënkuptojnë cenim serioz të të
16 drejtave të shumta të njeriut, duke shkaktuar dhimbje të rënda
17 që nuk përjetohet vetëm nga personat që janë zhdukur me forcë,
18 por dhe nga familjet e tyre, komunitetet e tyre dhe nga
19 shoqëria si e tërë. Shpesh ushtrohen si një strategji e
20 qëllimshme për kontroll përmes ushtrimit të terrorit dhe për
21 të shkaktuar dhimbje, për të mbjellë frikë, për të shtypur
22 personat dhe për të ndëshkuar komunitete të tëra."

23 Dhe do të flasim në fakt për një komunitet konkretisht që
24 është komuniteti serb.

25 Shumë prej këtyre viktimave ende kërkojnë përgjigje.

1 Shohim diapozitivin 10.

2 Dëshmitari 72 thotë që kërkon dhe do të kërkojë derisa të
3 vdesë. Ajo ka thënë kështu:

4 "Të jesh e fortë pas 25 vitesh e të kërkossh për djalin
5 dhe bashkëshortin dhe për këdo tjetër që u zhduk në këtë
6 mënyrë është shumë, shumë e vështirë. Nuk është e lehtë dhe
7 nuk ja uroj asnjë prindi të përjetojë këtë që kam përjetuar
8 unë. Kur më morën djalin, ma shkulën nga krahët, ishte njësoj
9 si të merrnin zemrën dhe zemra që më ka ngelur është për
10 pjesën tjetër të familjes. Kështu jetoj dhe kështu do të vdes.
11 Dhe do t'i kem këto mendime derisa të marr frymën e fundit, do
12 të mendoj për djalin dhe për burrin."

13 Siç e di dhe Trupi Gjykses, shumë prej familjeve kanë
14 kaluar me vite të tëra duke shpresuar të gjejnë mbetjet,
15 trupat. Fatkeqësisht disa nuk kanë mundur, disa kanë mundur,
16 disa kanë gjetur vetëm një pjesë të trupit. Të mos varrosësh
17 dot personin e dashur për shumë vite, apo përgjithnjë, është
18 po ashtu një formë dëmi. Të mos kesh një varr për ta vizituar
19 apo ta dish që varri ka thjesht një pjesë të trupit.

20 Disa viktimat kanë pasur veç vështirësi kur janë përpjekur
21 të zbulojnë çfarë u ndodhi familjarëve të tyre. Dhe dua të
22 përmend këtu familjet që janë prekur nga vrasjet pas sulmeve
23 të UÇK-së në zonën e Rahovecit në 1998-n. Ne kemi dëgjuar
24 lidhur me këtë në fakt nga Prokuroria dhe ka fakte për këtë
25 kuptohet, u sulmuan komunitetet, u burgosën shumë persona -

1 burra, gra dhe fëmijë. I morën kundër dëshirës së tyre. Ishin
2 të terrorizuar. Burrat dhe gratë i ndanë. Një djalë 16-vjeçar
3 u bashkua me burrat. Këta ishin persona që kryesisht punonin
4 tokën mes të cilëve edhe një mësues. I larguan. Dhe diku në
5 një pikë që nuk dihet më pas, i qëlluan. Trupat e tyre u
6 fshehën në një shpellë dhe u bënë përpjekje për të fshehur
7 identitetet e tyre, ka të ngjarë duke përdorur zjarrin apo
8 eksplozivë.

9 Ky ishte një krim kundër një komuniteti të tërë që u
10 shkatërrua për shkak të asaj që bëri UÇK-ja sikur të mos
11 kishin asnjë vlerë, sikur të ishin njerëz që nuk nevojiteshin
12 dhe të zhdukeshin që në rrënjë, të eliminoheshin që në rrënjë.

13 Ky ishte një komunitet i ngushtë dhe familjet ishin shumë
14 të lidhura me njëra-tjetrën. Si rezultat, shumë prej viktimave
15 humbën shumë anëtarë të familjes si dhe të afërm pak më të
16 largët. Shumë vite më pas jetuan me pasiguri, qarkullonin
17 fjalë se çfarë u kishte ndodhur burrave të tyre por askush nuk
18 e zbuloi asnjëherë deri në vitin 2004, 2005 kur u zbuluan disa
19 prej mbetjeve njerëzore. Gjithashtu humbën shtëpitë, ambientet
20 që quanin shtëpi. Asnjë nga ky grup nuk është kthyer më.

21 Sidoqoftë, ka mbetur një komunitet dhe e mbështetin
22 njëri-tjetrin edhe e ndihmojnë njëri-tjetrin kur ndajnë
23 përvojën e tmerrshme të vrasjes dhe të humbjes. Dhe asnjëherë
24 nuk janë pajtuar me këto krime të tmerrshme. Familjet në këtë
25 rast mendojnë se duhet të gjejnë drejtësi, të bëjnë drejtësi

1 për personat që kanë humbur. Është mbase mënyra e fundit dhe
2 më prekëse për t'u treguar që ata ende i duan me shpirt.

3 Të pranosh këto humbje është një nga format për t'u
4 ngushëlluar me faktin. Dhe do të flas për këtë shkurtimisht
5 ose më saktë pas pushimit të drekës. Është shumë e rëndësishme
6 që ta theksoj sa e rëndësishme është kjo për viktimat.

7 Të nderuar Gjykatës, mendoj se është momenti i
8 përshtatshëm për të bërë pushimin e drekës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Do të rikthehem në orën 1.30.

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.00

12 --- Seanca rifillon në orën 13.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
14 mund të na thoni që sa kohë ju duhet për të përfunduar me
15 prezantimin tuaj sa për planifikim?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Më duhen nga 20 deri në 30 minuta.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju doni të
18 filloni nesër, apo jo?

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës,
20 dëshirojmë që të fillojmë nesër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
22 mund të vazhdoni më tej, z. Laws.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Ne po trajtonim temën e
24 personave të dashur të humbur, në veçanti duke u marrë me
25 familjet serbe nga Rahoveci.

1 Këto familje, por gjithashtu edhe shumë e shumë familje
2 të tjera të cilët kanë humbur personat e tyre të dashur për
3 shkak të një vrasjeje janë ekspozuar ndaj asaj çfarë ekspertët
4 e shëndetit mendor e njohin si humbje ambige, po pa kuptim.
5 Dhe kjo lloj humbjeje do të thotë që nuk ka konfirmim që
6 personi i familjes ka vdekur, domethënë nuk gjendet trupi dhe
7 nuk dihet se çfarë ka ndodhur me personin në fjalë. Sikurse e
8 shpjegojnë ekspertët pasiguria e cila lidhet ngushtë me një
9 humbje të tillë është traumatike në vetvete. Mungesa e
10 qartësisë iu jep anëtarëve të familjes shpresë dhe kjo shpresë
11 e bën të vështirë që ata të pranojnë vdekjen. Ne këtë
12 konstatim e shikojmë nga ekspertët dhe kjo pasqyrohet në
13 përvojat e vetë viktimave.

14 Për shembull, Dëshmitari 4489, që humbi bashkëshortin e
15 saj, asnjëherë nuk ka pasur provë të vdekjes së tij dhe ajo ka
16 folur përpara nesh se si ka jetuar 25 vite të tëra që në fakt
17 kanë qenë vite jetë në pasiguri të cilat çonin në torturë. Dhe
18 për të përdorur fjalët e saj, pra, "kjo ka qenë një torturë e
19 vërtetë". Këtë mund ta gjeni në transkript në faqen 11377.

20 Ne kemi dëgjuar gjithashtu edhe anëtarë të familjeve të
21 ndryshme të cilat kanë shkuar nga derë më derë, kanë trokitur
22 në të gjitha dyert e mundshme po ashtu kanë vënë njoftime në
23 shtyp, janë munduar me të gjitha mjetet e mundshme sepse,
24 sikurse e thotë një prej dëshmitarëve që është Dëshmitari
25 4566, shpresa vdes e fundit. Kjo jepet në transkript në faqen

1 T6959.

2 Në qoftë se do shohim vrasjet e bëra nga UÇK-ja në
3 përgjithësi, jo vetëm ato që kanë të bëjnë me këtë lloj humbje
4 të paqartë, ose ambige, ajo çfarë shohim është që këto janë
5 vrasje të cilat janë injoruar, janë mbuluar dhe janë fshehur
6 ndërkohë që sigurisht që UÇK-ja duhet të kishte marrë hapa për
7 hetimin, dokumentimin, ndjekjen penale të tyre. Edhe të
8 flasësh për të ndonjëherë ishte tabu në shoqërinë kosovare dhe
9 disa viktima mësuan që të heshtnin.

10 Dëshmitari 4712 tha që familjet, familjarët e tij nuk
11 flisnin për vdekjen dhe heshtnin për shkak të frikës. Heshtnin
12 për shkak të frikës që e njëjta gjë mund t'ju ndodhte dhe vetë
13 atyre. Por të mos flasësh e bën edhe më të rëndë vajtimin dhe
14 kjo jepet konkretisht nga viktima 17 në faqen 2549.

15 Natyra e fshehur e këtyre krimeve ka kontribuar për
16 stigmatizim të mëtejshëm të personave të mbijetuar në
17 komunitet e tyre. Frika dhe ndjesia e stigmës është edhe sot e
18 kësaj dite e fortë ndërmjet shqiptarëve të Kosovës që janë
19 viktima dhe që jetojnë ende në Kosovë, por ndërmjet viktimave
20 të tjera po ashtu që të cilët janë larguar nga vendi për shkak
21 të frikës dhe pasigurisë. Dhe është e kuptueshme që shumë prej
22 këtyre familjeve humbën jo vetëm një person të dashur të
23 familjes por edhe kryetarin e familjes, kreun e familjes që i
24 mbante ata me bukë dhe një ditë e gjetën veten në mes të
25 asgjëje duke u përpjekur që të mbijetonin.

1 Tema tjetër të cilën unë do ta trajtoj nën titullin
2 humbja e personave të dashur, është dëmi që kalon nga brezi në
3 brez, duke u përqendruar tek fëmijët që janë viktimat
4 pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor. Kur flasim për viktimat
5 është e rëndësishme që të kuptohen efektet e krimeve të tilla
6 të rënda mbi të gjitha familjet, por në veçanti fëmijët e
7 viktimave të drejtpërdrejta janë po aq të rëndësishme për të
8 kuptuar dimensionin e krimeve të tilla.

9 Mund të shikoni, për shembull, diapozitivin 11 që ju jep
10 një vështrim të përgjithshëm të këtyre personave, pra, të
11 fëmijëve që kanë qenë ose të lindur ose të palindur gjatë
12 kohës së krimeve.

13 Për shembull, janë 28 prej 155 viktimat pjesëmarrëse në
14 këtë çështje të cilët kanë qenë 18 vjeç ose më të rinj në
15 kohën kur kanë ndodhur këto ngjarje. Po ashtu kemi edhe shtatë
16 viktimat pjesëmarrëse të cilët kanë qenë 6 vjeç ose më pak sesa
17 kaq kur kanë humbur baballarët e tyre; dhe ndërkohë kemi katër
18 viktimat pjesëmarrëse të cilët as nuk kishin lindur ose ishin
19 më pak sesa një vjeç në kohën që kanë humbur babanë.

20 Dhe madje kemi edhe një rast kur viktimat pjesëmarrëse ka
21 humbur prindin përpara sesa të ishte i vetëdijshëm për faktin
22 që kishte një prind. Dhe këto janë fëmijë të cilët janë rritur
23 në mjedise ku ka pasur vazhdim të përhershëm dhe ku ka pasur
24 gjithmonë pyetje të papërgjigjura lidhur me fatin e
25 baballarëve të tyre.

1 Sikurse është thënë prej ekspertëve të shëndetit mendor
2 në provat e pranuar në këtë çështje gjyqësore - dhe për këtë
3 dua që të kërkoj që të paraqitet diapozitivi 12, - "Trauma në
4 këto familje ka ndikim mbi fëmijët si në kohën kur ndodhin
5 ngjarje të tilla ashtu edhe në brezat e tjera që do të lindin
6 në të ardhmen".

7 Një dëshmitar na ka dhënë dëshmi se si djali i saj pyeste
8 se pse fëmijët e tjerë kishin baba, ndërkohë që babai i tij
9 ishte vrarë dhe kush e kishte vrarë atë. Këto viktime e kanë
10 gjetur veten pa asnjë lloj faji në dëmin që po vuanin familjet
11 e tyre dhe me pyetje të pazgjidhura e pa përgjigje lidhur me
12 fatin e prindërve e baballarëve të tyre edhe sot e kësaj dite.

13 Disa viktime të cilët kanë qenë të rritur në kohën kur
14 kanë ndodhur ngjarjet kanë shpjeguar procesin e trashëgimit të
15 traumës edhe ndaj familjeve -- ndaj fëmijëve të tyre. Për
16 shembull, Dëshmitari 4870 shpjegoi që të rritesh me një nënë
17 me një stres kaq shumë të madh, është një stres i cili ka
18 dëmtuar në mënyrë serioze fëmijët e vet, pavarësisht faktit që
19 fëmijët kanë lindur pas luftës.

20 Dëshmitari 4566 përshkuan një traumë familjare të shtrirë
21 në kohë që buronte nga fakti që bashkëshorti i saj ishte
22 zhdukur dhe se si një gjë e tillë kishte ndikim mbi fëmijët të
23 cilët duhej që të jetonin pa praninë e babait e tyre dhe me
24 shpresën e largët që një dite ai do të kthehej. Për këtë mund
25 të shikoni dy citime, konkretisht 1066 dhe 6959.

1 Po ashtu kemi një dëshmitar tjetër, 4371, që dëshmoi se
2 si shumë vite nuk iu tregonte fëmijëve të vet se çfarë i
3 kishte ndodhur babait të tij, domethënë gjyshit të fëmijëve
4 dhe kush e kishte vrarë atë, kështu që fëmijët e tij u rritën
5 në një botë ku kishte sekrete dhe mistere lidhur me zhdukjen e
6 gjyshit të tyre.

7 Këto shembuj ilustrojnë mekanizmat përmes të cilëve
8 vepron dëmi që kalon nga një brez tek tjetri në familjet e
9 viktimave. Është edhe një aspekt i veçantë i dëmit të jesh
10 prind i traumatizuar, të shohësh dhe të dish që fëmijët e tu
11 vuajnë për shkak të ngjarjeve të cilat ata nuk i kanë parë
12 asnjëherë vetë dhe në lidhje me të cilët nuk kanë pikë faji.
13 Kjo është një pasojë tjetër e humbjes së personave të dashur
14 për këto viktima dhe është gjithashtu edhe një burim shtesë i
15 vuajtjes së tyre.

16 Dhe në këtë mënyrë vendimet e marra shumë vite më përpara
17 për të ndaluar njerëz dhe më pas për t'i ekzekutuar ata luajnë
18 rolin e tyre negativ edhe sot e kësaj dite në jetën e atyre
19 personave të cilët asokohe ishin fëmijë, foshnje, madje mund
20 të kishin qenë edhe të palindur fare, dhe në jetën e prindërve
21 të tyre po ashtu.

22 Tani do të kaloj te pika e pestë, humbja e shtëpisë.

23 Kur trajtojmë humbjen e shtëpisë ne përqendrohemi në
24 thelb në viktimat serbe të cilat janë zhvendosur jo për shkak
25 të konfliktit në vetvete por për shkak të veprimeve të

1 anëtarëve të UÇK-së. Pika fillestare është parimi ligjor dhe
2 ky është një ndër parimet kryesore ku thuhet që viktimat kanë
3 të drejtën e zhdëmtimit përfshirë këtu kthimin në vendbanimin
4 e tyre, kthimi në vendin e punës që kanë pasur më përpara dhe
5 kthimin e pronave të tyre. Dhe kjo, në fakt, sikurse e dimë
6 është mundësi vetëm për një numër të vogël viktimash edhe jo
7 për pjesën dërmuese të viktimave, pra, që kthehen në shtëpitë
8 e tyre të mëparshme dhe të nisin atë mënyrë jetese që kanë
9 pasur shumë vite më përpara. Ky është një grup i cili ka
10 vuajtur një dëm shumë specifik dhe ne e ftojmë Gjykatën që
11 këtë dëm ta njohë në aktgjykimin e vet duke zbatuar nenin
12 22(7).

13 Konflikti në vetvete nuk kishte asgjë në thelb që e bënte
14 të paevitueshme largimin e civilëve serbë. Shumë prej këtyre
15 civilëve serbë kishin jetuar në mënyrë paqësore së bashku me
16 komshinjtë e tyre shqiptarë. Në shumë raste dhe pararendësit e
17 tyre kishin jetuar në Kosovë për breza e breza të tërë, ca
18 prej të cilëve edhe për qindra vite. Dhe për shumë prej tyre
19 është e drejtë të thuhej që ata i takojnë asaj toke po aq sa
20 ajo tokë u takon atyre. Dhe të humbje gjithçka ka qenë një
21 burim i një vajtimi të vazhdueshëm të këtyre familjeve të
22 prekura. Duke bërë dallimin ndërmjet dy elementëve kryesorë.
23 Së pari janë godinat e shtëpisë, domethënë: tullat dhe muret e
24 shtëpisë, gjithashtu edhe feramat, ndërtesa në ferma edhe në
25 shumë raste familjet serbe janë detyruar që të largohen dhe

1 shtëpitë e tyre janë shkatërruar në të njëjtën kohë ose
2 menjëherë pasi ata janë larguar. Dhe kjo përbën një dëm të një
3 natyre të rëndë. Shumë familje janë larguar dhe kanë marrë
4 çfarë kanë mundur për momentin dhe kanë filluar nga zeroja ku
5 kanë shkuar më pas, që mund të ketë qenë në serbi ose diku
6 tjetër.

7 Humbja e shtëpive të tyre në këtë kuptim është humbja e
8 vendit ku ata banonin, e vendit që i përkisnit.

9 Le t'i referohemi një shembulli.

10 Dëshmitari 1140, ai thotë:

11 "Ne nuk u larguam, thjesht u larguam, ne u dëbuam, kjo
12 është histori tjetër. Është një gjë të largohesh dhe është
13 tjetër gjë që të dëbohesh prej dikujt. Kështu që ju kërkoj
14 ndjesë por është një dallim i rëndësishëm ky për t'u marrë
15 parasysh."

16 Ndërkohë të tjerët thonë që ishte e vështirë që të
17 qëndroje. Për shembull, Dëshmitari 2749 i cili na tregoi se
18 për çfarë përfshinte humbja, thotë si më poshtë. Ishte fundi i
19 jetës në një qytet ku ai ishte rritur, ishte fundi i punës së
20 vet, ishte fundi i ëndrrave që kishte për të ardhmen. Të
21 gjitha u fshinë, ndërkohë që jeta e tij mori një drejtim mbi
22 të cilin ai nuk kishte asnjë lloj kontrolli.

23 Dëshmitari 01 është një tjetër shembull. Ai largua nga
24 Kosova pasi u ndalua nga UÇK-ja dhe pasi e kishte absolutisht
25 të pamundur të vazhdonte të jetonte ai, për arsye të

1 përcaktuara në deklaratën e vet. Është e qartë se si largimi i
2 tij ka pasur ndikim -- ka ndikim edhe sot e kësaj dite. Përveç
3 diagnozës së stresit post traumatik që ka dhe përveç trajtimit
4 të rregullt që merr, ai ka humbur komunitetin, ka humbur
5 lidhjet e tij, ka humbur shokët e miqtë, dhe për të kjo do të
6 thotë që ai ka humbur si të shkuarën po gjithashtu edhe të
7 ardhmen që kishte menduar për veten përpara sesa të rrëmbehej.

8 Unë këtë e kam quajtur "humbje e shtëpisë" për të
9 përfshirë si ndikimin material ashtu edhe ndikimin psikologjik
10 të këtij dëmi, por shpresoj që të jetë e qartë që kjo shprehje
11 synon që të shprehë gjithashtu edhe sensin apo kuptimin e
12 mërgimit apo të largimit.

13 Unë fola për lloje të ndryshme dëmsh, por dëshiroj që të
14 përfundoj me parashtrimet e mira sot nëse më lejoni duke dhënë
15 disa konstatime lidhur me rëndësinë e këtij gjykimi dhe madje
16 edhe disa fjalë për të ardhmen.

17 Kemi parë bashkërisht që pasojat për viktimat në këtë
18 çështje nuk janë të kufizuara vetëm tek pasojat fizike ose
19 psikologjike. Për disa, ata vazhdojnë që të jetë objekt i
20 stigmës së vazhdueshme për shkak të dëmit që kanë pësuar nga
21 UÇK-ja, që në sytë e disa vetëve në komunitet tregon pabesinë
22 e tyre. Viktimat flasim për këtë sikur kjo të ishte një marker
23 i dukshëm që ishte vendosur mbi ta. Dhe fjala "njollosje"
24 përdoret prej tyre për të përshkruar ndjenjën e marrjes së një
25 etiketimi të tillë të turpshëm. Kosova është një vend ku

1 reputacioni i familjes është një gjë e vyer.

2 Dëshmitari 1743, kur fliste lidhur me periudhën pasi
3 ishte vrarë i ati tha që njerëzit ishin të frikësuar që të
4 kishin ndonjë lloj marrëdhënie me të apo me familjen e tij.
5 Dhe për këtë më konkretisht mund t'i referoheni provës
6 P1893.2, faqja 8 deri në 9.

7 Në momentin kur një viktimë e një krimi për shkak të
8 identitetit dhe natyrës së kryesve njerëzit të fajësojnë,
9 njerëzit të shohin ndryshe.

10 Ndërkohë një tjetër dëshmitar, Dëshmitari 1798 [Sipas
11 përkthimit] foli për mënyrën se si e shikonin personat, se si
12 e shikonin njerëzit për shkak të faktit që ishte ndaluar.

13 Të shikojmë diapozitivin 14.

14 "Mënyra se si i trajtonin personat, njerëzit pas luftës
15 për shkak të faktit që UÇK-ja të kishte ndaluar ishte e qartë.

16 "Pra, ideja ishte që njerëzit mundoheshin që të thoshin
17 që nuk dua të mbaj anën tënde sepse mund të më marrin mua
18 nesër dhe njerëzit e marrë nga UÇK-ja ishin spiunë, ishin
19 persona të këtij niveli."

20 Ky lloj stigmatizimi është një lloj ose formë e veçantë
21 traume edhe padrejtësie. Mund të ketë pasur pretendime të
22 ndryshme që ndoshta familja juaj shënjestrohej, që ndoshta
23 është shënjestruar për ndalim, për rrahje, për vrasje, por
24 tani fakti që ti ke qenë i shënjestuar ose familja jote ka
25 qenë e shënjestruar është një pasaportë, është një dritë

1 jeshile për përjashtim dhe për mospërfshirje. Por, jo vetëm që
2 ti hasesh me padrejtësi, po në rastin e shumë viktimave bëhej
3 fjalë për një drejtësi -- një padrejtësi gjithëpërfshirëse që
4 kryesit origjinalë nuk kishin mbajtur asnjëherë përgjegjësi
5 për krimet e kryera dhe kjo ndjesi padrejtësie, sikurse e
6 sugjerojmë ne, i ka bërë viktimat që të ndiheshin në një nivel
7 të tillë.

8 Ekspertët e shërbimit mendor vërejtën që ekzistonte një
9 përqindje e lartë e viktimave që kishin përmendur mungesën e
10 drejtësisë si një element i rëndësishëm për ta. Ata gjithashtu
11 vërejtën dhe efektin negativ të mosnjohjes së drejtësisë për
12 viktimat.

13 Do i kërkoja Sekretarit të kalojmë te diapozitivi 15
14 tani.

15 "... çështje të shëndetit mendor përkeqësohen nga stresi
16 i vazhdueshëm social dhe ekonomik, përveç mungesës së
17 drejtësisë dhe mbështetjes institucionale."

18 Ka shumë viktima, që jam i sigurt që ky Trup Gjykues mund
19 të identifikojë, që jo vetëm nuk kanë qenë objekt i
20 drejtësisë, por tërësisht e kundërta ka qenë për ta për sa i
21 takon mbështetjes institucionale, dhe çështje të shëndetit
22 mendor pa diskutim që janë përkeqësuar nga stresi social dhe
23 ekonomik të shkaktuar nga personat që i kanë keqtrajtuar ata
24 apo vrarë ata.

25 Është absolutisht një përgjigje bazë, një përgjigje

1 themelore, njerëzore që të dimë, që të jepet llogari për
2 krimet e kryera ndaj personave të dashur për ne. Padrejtësia
3 fillestare e krimit, plus njohuria që këto krime nuk janë
4 pranuar, shtuar kësaj dhe refuzimi i marrjes së përsipër të
5 përgjegjësisë ose kërimit të faljes për atë çfarë kanë bërë,
6 të duket sikur bota nuk e merr seriozisht atë çfarë ka
7 ndodhur, të duket sikur botës nuk i bëhet vonë fare.

8 Imagjinoni sikurse të ishit ju një prej familjeve në këtë
9 çështje që të keni jetuar për 25 vite, jo vetëm pa pasur një
10 përgjigje por pa pasur as shpresën për të marrë një përgjigje
11 deri në momentin kur u themelua kjo gjykatë. Dëshmitari 4781
12 thotë si më poshtë, ai dhe familja e tij kishin qenë viktimë
13 të krimeve të tmerrshme. Ai foli për mënyrën se si përpara
14 sesa të themelohej DHSK-ja ata kishin hequr dorën nga çdo
15 shpresë drejtësie dhe se si ai dhe shumë të tjerë - këto janë
16 fjalët e tij, domethënë - ai dhe shumë të tjerë mendojnë se
17 kjo gjykatë është shpresa e fundit që ata kanë.

18 Për referencë këtë mund ta lexoni në transkript në faqen
19 T8431 deri në 2.

20 Një rezultat që pranon dënim e vuajtur nga viktimat në
21 vetvete është mjet për trajtimin e dëmit të pësuar. Trupi
22 Gjykues I e ka pranuar këtë të vërtetë të qartë në
23 jurisprudencën e vet.

24 Do i kërkoja Sekretarit tani të paraqesë diapozitivin 16.
25 Këtu kam përshirë një fragment nga vendimi, nga aktgjykimi në

1 Çështjen 04:

2 "Trupi Gjykues është i mendimit që pranimi i shkeljeve të
3 rënda të të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare
4 ndërkombëtare dhe si zhdëmtimet për dëmin e pësuar si rezultat
5 i këtyre shkeljeve, janë një formë e rëndësishme zhdëmtimi për
6 viktimat."

7 E ftoj Trupin Gjykues që të zbatojë të njëjtin parim
8 këtu. Ky është një parim që është në përputhje me
9 jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
10 sikurse e demonstroi Trupi Gjykues në të njëjtin vendim në
11 paragrafët 21 deri 28 të tij. Ai po ashtu njeh përvojat e
12 viktimave dhe viktimat në vetvete gjejnë një lloj drite
13 jeshile po të dinë që drejtësia vendoset në vend.

14 Aktgjykimi në këtë çështje gjyqësore, të nderuar
15 Gjykatës, është një mundësi që këta dhe të gjitha viktimat
16 pjesëmarrëse në proces të gjejnë disa përgjigje për pyetjet që
17 kanë dhe që personat që i kanë bërë atë çfarë i kanë bërë
18 personave të tyre të dashur vite më përpara të mbajnë
19 përgjegjësi dhe është një mundësi për ta që të dëgjohen dhe që
20 dhimbja e tyre të njihet. Dhe kjo është e rëndësishme të bëhet
21 jo vetëm prej kësaj Gjykate, dhe kjo është e rëndësishme që
22 edhe për publikun në Kosovë dhe gjetkë mendoj që kjo është një
23 mundësi që viktimat në fund të lejohen të flasin e të ngrenë
24 zërin për të drejtat e tyre, përfshirë këtu dhe të drejtën për
25 të vërtetën, për të ditur të vërtetën lidhur me atë çfarë i ka

1 ndodhur personave të tyre të dashur pa qenë nën trysni dhe pa
2 qenë të frikësuar se do të quhen armiq.

3 Fatkeqësisht, ka ende persona në Kosovë që insistojnë që
4 UÇK-ja nuk ka kryer asnjë krim dhe që UÇK-ja ka luftuar një
5 luftë të drejtë pa defekte morale. Megjithatë, pavarësisht
6 kësaj, janë bërë përpjekje që viktimat e UÇK-së që kanë
7 bashkëpunuar me këtë Gjykatë të përshkruhen si persona të
8 pabesë për Kosovën.

9 Dëshmitari 04735, një burrë shumë guximtar, ka dhënë
10 dëshmi përpara Gjykatës pa masa mbrojtëse në mënyrë të tillë
11 që të gjithë ta merrnin vesh se çfarë kishte për të thënë ai.
12 Ai përshkroi se si dëshmitarët që kanë dëshmuar në DHSK
13 përshkruhen në mënyrë të rreme në median e Kosovës si
14 tradhtarë dhe që janë bashkëpunëtorë, janë në të njëjtën linjë
15 me Serbinë dhe atyre ju është treguar që të mbajnë gojën e
16 mbyllur dhe të mos flasin. Kjo jepet në transkript në T19417
17 [Sipas përkthimit]. Kjo kontribuon për dëmin e vazhdueshëm të
18 viktimave pjesëmarrëse të cilat padrejtësi pas padrejtësie
19 vazhdojnë që të jenë të padukshëm dhe vazhdojnë të fajësohen
20 në qoftë se bëjmë ndryshe. Ata nuk i shërbejnë personave që
21 duan që të pohojnë dhe që i qëndrojnë pozicionit që UÇK-ja nuk
22 ka pikë faji dhe nuk ka shkaktuar viktima.

23 Duhet të jemi të qartë lidhur me diçka, krimet dhe
24 mizoria që ka shoqëruar këto krime, keqtrajtimi mizor, vrasjet
25 brutale, përpjekjet cinike për të fshehur krimet, të gjitha

1 këto kanë ndodhur. Dhe mohimi i këtij fakti është thjesht një
2 gënjeshtër tjetër mizore. E vërteta e asaj se çfarë u ka
3 ndodhur këtyre personave është e vështirë që të pranohet sepse
4 ndoshta kjo nuk e përshtatshme me narrativen e luftës së UÇK-
5 së sepse ata kanë shkaktuar viktimë në popullatën e tyre
6 civile dhe jo-luftëtarëve serbë, pra, megjithatë mendoj që në
7 qoftë se një gjë e tillë pranohet, kjo në vetvete do të sjellë
8 pak më tepër paqe në jetët e viktimave,

9 Dy gjëra mund të jenë të vërteta, UÇK-ja mund të ketë
10 luftuar një luftë çlirimtare, mund ta ketë bërë një gjë të
11 tillë dhe pjesa dërmuese e luftëtarëve të saj e ka bërë këtë,
12 pra, ka bërë një luftë çlirimtare, por është e vërtetë edhe e
13 kundërta, që anëtarë të UÇK-së të kenë kryer krime. Këtë e ka
14 bërë të qartë pikërisht Dëshmitari 4368, babai i të cilit
15 është vrarë nga UÇK-ja me pretendimet që ka qenë
16 bashkëpunëtor. Ai tha që ai e ka mbështetur UÇK-në që nuk ka
17 vrarë shqiptarët. Për procesverbal kjo mund të gjendet në
18 transkript në T7079.

19 Fakti që këto krime janë kryer nga anëtarët e UÇK-së, nuk
20 e bën UÇK-në një organizatë kriminale. Ka ardhur koha tanimë
21 që të merret përgjegjësia përsipër jo vetëm për atë çfarë
22 shumë shqiptarë e shikojnë si veprime që i sollën lirinë UÇK-
23 së, por gjithashtu për gjërat jo aq shumë të mira të bëra dhe
24 që janë pjesë e këtij gjykimi. Askush, askujt nuk i bëhet nder
25 duke u ngjitur në një version të së shkuarës që kërkon që ta

1 nxjerrë fitimtar vetëm njërin version.

2 Pavarësisht se cili do jetë vendimi për këta katër të
3 akuzuarit, ne shpresojnë që në emër të viktimave vendimi të
4 jetë që këta 155 persona vërtetë kanë qenë viktima të krimit
5 dhe që nuk ekziston asnjë lloj justifikimi për çfarëdolloj
6 gjëje që këta persona kanë pësuar. Çfarëdo të ndodhë më pas,
7 këtë do të duhet të presim e ta shohim, por ne parashtrojmë që
8 kjo është pjesë e përgjigjes së duhur ndaj këtyre krimeve dhe
9 është një pjesë që mund t'ju japë pak dritë jeshile këtyre
10 njerëzve të cilët kanë vuajtur kaq shumë nga padrejtësitë.

11 Faleminderit shumë për vëmendjen. Unë kaq kisha për të
12 thënë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 z. Laws.

15 Atëherë edhe për sot përfunduar. Do të fillojmë nesër me
16 Mbrojtjen e Thaçit, me deklaratat përmbyllëse të z. Thaçi në
17 orën 9.00. Do të shihemi nesër në orën 9.00.

18 Këtu mbyllet seanca për sot.

19 --- Seanca mbyllet në orën 14.00

20

21

22

23

24

25